



# Mbrojtja

Viti i 88-të i botimit  
Nëntor 2020/ Nr. 11



**Rihapen pas 10 vitesh studimet në AFA  
Xhaçka: Synojmë ta  
ngremë në nivelin e  
vendeve të NATO-s**



**Bajram Begaj-Fabrice Duda  
Bashkëpunimi  
ushtarak me Francën  
do të vazhdojë**



**Ministrja e Mbrojtjes Xhaçka  
Buxheti i  
Mbrojtjes 2021, ja  
drejtimet kryesore**



**MBËSHTETJA E ALEATËVE NË RRITJEN E KAPACITETEVE PROFESIONALE  
Rama: Forcat e Armatosura gëzojnë reputacion  
të jashtëzakonshëm në gjirin e NATO-s**

# Përmbajtja

Numri 11

## BIBLIOTEKA E AFA

- 7** Biblioteka e Akademisë pasurohet me 220 tituj dhe 600 kopje librash

## MARRËVESHJA

- 12** Baza e Kuçovës: Projekti dhe investimi realizohen nga Programi i Investimeve të NATO-s

## BASHKËPUNIMI

- 14** Do përdoren edhe avionë në përballimin e fatkeqësive natyrore

## TAKIMI

- 16** Forca Shumëkombëshe e Europës Juglindore, kontribuon në sigurinë dhe stabilitetin rajonal

## AKTIVITETI

- 36** Femrat ushtarake përbëjnë rreth 14 % të personelit ushtarak të FA

## STAFI

### DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

### Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA  
HAJRIE DEDAJ

### Redaktore/ korrektore:

SUELA HODO

### Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



## 4 MBËSHTETJA E ALEATËVE

### Rama: FA gëzojnë reputacion të jashtëzakonshëm në gjirin e NATO-s

Falë bujarisë së SHBA-së dhe nëpërmjet NATO-s, Shqipëria pajiset me plus 60 respiratorë të rinj që i shtohen fuqisë së instaluar për të luftuar COVID-19 në Spitalin Infektiv...



## 6 RIHAPEN STUDIMET NË AFA

### Xhaçka: Synojmë ta ngremë në nivelin e vendeve të NATO-s

Akademia e Forcave të Armatosura ka rihapur pas 10 vjetësh ndërprerje studimet në nivel bachelor. 60 të rinj e të reja fitues, nisën këtë të hënë studimet në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë...



## 8 BUXHETI I MBROJTJES 2021

### Rritja 2,7 miliard lekë ose 11,8% më shumë se në vitin 2020

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2021 ka një rritje prej rreth 2,7 miliard lekëve, ose 11,8% më shumë se në vitin 2020. Ministria...



## 24 NË POLIGONIN KOMBËTAR TË BIZËS

### Përfundon stërvitja 72-orëshe e koduar "Stuhia 20-05"

Kompania e Dytë dhe Kompania Mbeshtetëse e Batalionit II Këmbësorisë nga data 20 deri 22 tetor, zhvilloi stërvitjen 72-orëshe të koduar...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

# Mbrojtja



## REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror  
i Ministrisë së Mbrojtjes  
Viti i 88-të i botimit  
Nr. 11/2020

### © Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë  
revistë nuk mund të riprodhohen  
elektronikisht apo fizikisht e të  
përdoren për qëllime përfutimi, pa  
marrë autorizim nga botuesit e saj.

### Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,  
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe  
Botimeve të Mbrojtjes

### Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

Revista mund të gjendet në formatin  
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/  
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)







MBËSHTETJA E ALEATËVE NË RRITJEN E KAPACITETEVE PROFESIONALE

## Rama: FA gëzojnë reputacion të jashtëzakonshëm në gjirin e NATO-s

*Të gjitha vendet gjenden në një anije dhe duhet të përballin dallgë vështirësish që godasin me të njëjtin intensitet kudo dhe ndërkohë solidariteti nuk ka munguar dhe as vëmendja për vende më të vogla*

**F**alë bujarisë së SHBA-së dhe nëpërmjet NATO-s, Shqipëria pajiset me plus 60 respiratorë të rinj që i shtohen fuqisë së instaluar për të luftuar COVID-19 në Spitalin Infektiv, atë Shefqet Ndroqi dhe në spitalet e reja COVID 3 dhe 4 deri në daljen nga ky dimër sfidues". Kështu u shpreh ditën e enjte, më 22 tetor 2020, Kryeministri Edi Rama, në ceremoninë e dorëzimit të 60 respiratorëve, si donacion i NATO-s, zhvilluar në ambjentet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit

të Përgjithshëm të FA, ndërsa vlerësoi se "miqtë e mirë duken në ditë të vështira".

Kryeministri shprehu mirënjohjen ndaj SHBA-së, që si gjithnjë dhe në këtë rast janë treguar të vëmendshme ndaj Shqipërisë. "Dua ta falënderoj në mungesë ambasadorën e SHBA-së, Kim, e cila ma dha e para lajmin për këtë mbështetje kaq të çmuar dhe kaq të nevojshme në këtë fazë përballjeje me një armik kaq të pamëshirshëm që i ka rënë ndesh jo vetëm shëndetit, por edhe mënyrës sonë të të jetuarit", tha

Rama. Rama bëri një retrospektivë të disa momenteve kur Shqipëria ka prekur nga afër mbështetjen me bazë materiale që duhet në përballimin e kësaj sfide. "Por ndryshe nga momentet e tjera në të shkuarën, nuk është thjesht vetëm Shqipëria që ka nevojë për ndihmë, por të gjitha vendet. Vetë SHBA kaluan një moment të befasishëm kur kishin nevojë për ndihmë. Kishte momente kur SHBA, Franca, Britania e Madhe dhe plot fuqi të mëdha kishin mungesë maskash mbrojtëse, respiratorësh, medikamentesh adapte për të për-



balluar të keqen në trupin e qindra mijëra njerëzve që krijuan një fluks të paparë në sistemet shëndetësore”, tha Rama. Kryeministri theksoi se “pavarësisht madhësisë dhe fuqisë së vendeve, të gjitha vendet gjenden në një anije dhe duhet të përballin dallgë vështirësish që godasin me të njëjtin intensitet kudo dhe ndërkohë solidariteti nuk ka munguar dhe as vëmendja për vende më të vogla. “60 respiratorët për të përballuar

këtë dimër që do të jetë i vështirë sipas parashikimeve të ekspertëve, janë kuptimplotë jo vetëm në aspektin e gjestit, por edhe në aspektin e ndihmës konkrete në fuqizimin e sistemit. Nga sot edhe këta respiratorë do të jenë në vijën e zjarrit për të mbrojtur e shpëtuar jetë”, tha Rama.

Kryeministri vuri në dukje se “sa shumë po bëhet nga Forcat e Armatosura sot në të dyja planet, në mbështetjen e domosdoshme për bluzat e bardha, për sistemin e mbrojtjes së shëndetit dhe në pjesëmarrjen e domosdoshme në operatione të rëndësishme jashtë vendit, kudo ku Aleanca është përfshirë”.

“Ky është një tjetër moment i jetës sonë të përbashkët kur vlera dhe fuqia e FA-së del në pah

me dinjitet dhe efikasitet të plotë. Këtu pas meje është pasqyra e një transformimi që vazhdon dhe është shprehja kuptimplotë e faktit se sot ndryshe nga dje, Shqipëria ka në dispozicion një trup të Emergjencave Civile të standardeve europiane, ku jo vetëm janë plotësuar nevojat materiale e logjistike, por ku sot shërben një trupë e cila është në lartësinë e imazhit, frymës, profesionalizmit të FA-së, si të tërë”, tha Rama.

Rama tha se “nuk e ka ditur dhe as menduar më parë, reputacionin e jashtëzakonshëm që gëzojnë FA në gjirin e NATO-s për nga niveli i tyre profesional”. “Nuk e kam ditur dhe menduar që në rreshtin e gjatë të ushtrive shumë më të mëdha me eksperiencë të sofistikuar, njerëzit tanë vlerësohen si ekselentë në të gjitha nivelet. Nuk e kam ditur që në stërvitje apo simulime të bëra nga NATO, skuadrat tona mund të arrijnë deri në vendet e nderit në gara të jashtëzakonshme vështirësish ekstreme, siç ndodhi jo shumë kohë më parë. Nuk ka kënaqësi më të madhe se sa kur dëgjoj nga autoritetet më të larta të NATO-s apo gjeneralë me hije të rëndë në takime që i sjell rasti, fjalë admiruese për FA”, tha Rama.

Natyrisht, vijoi ai, “kjo rritje e profesionalizmit nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e aleatëve tanë në rritjen e kapaciteteve morale dhe profesionale të njerëzve tanë. Por pa diskutim kjo nuk do ishte e mundur nëse drejtuesit e lartë të ushtrisë sonë nuk do të ishin në lartësinë e detyrës”, tha Rama.



**A**kademia e Forcave të Armatosura ka rihapur pas 10 vjetësh ndërprerje studimet në nivel bachelor. 60 të rinj e të reja fitues, nisin këtë të hënë studimet në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Akademia e Forcave të Armatosura ka çelur këtë të hënë, më 2 nëntor 2020, dyert për 60 studentë fitues, nga 600 aplikantë të cilët shprehën ambicie për të ndjekur studimet ushtarake. 60 studentët fitues që nisin udhën e tyre të dijes pranë Akademisë së Forcave të Armatosura do të ndjekin studimet e programit bachelor në Fakultetin e Shkencave Ushtarake. "Mirënjohje e vlerësim për të gjithë pedagogët, bashkëpunëtorët dhe stafin e Akademisë së Forcave të Armatosura, të cilët shenjuan këtë moment të rëndësishëm për arsimimin e brezit të ri", u shpreh ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, gjatë aktivitetin e zhvilluar mëngjesin e sotëm në kampusin e Universitetit të FA ku u uroi atyre vit të suksesshëm. Në ceremoninë në fjalë mori pjesë dhe ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Evis Kushi.

Në fjalën e tij, ish-pedagogu i Akademisë së Forcave të Armatosura, Kostaq Karoli, u shpreh se angazhimi në FA është një përgjegjësi e madhe. "Jetojmë në një kohë të vështirë për shkak të pandemisë dhe ndërmarrja e kësaj rruge mbarat përgjegjësi dhe sakrificë. Ju uroj suksese dhe si pedagogëve, ashtu edhe studentëve që nisin këtë rrugëtim", - tha Karoli.

"Kjo ditë do ngelet e shënuar në FA, pasi kurorëzon përpjekjet për ngritjen e një sistemi arsimor në harmoni me ambiciet e FA. Për herë të parë këtë vit, studimet do të kryhen plotësisht të organizuara në bazë të arsimit të lartë me një kurikul të pasur për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, i akredituar në ciklin Bachelor. Për të mbërritur këtu është dashur punë e sakrificë, e cila do të përkthehet në formësimin e të ardhmes së FA", - u shpreh më tej, shefi i SHPA, gjeneral major Bajram

# Xhaçka: Synojmë ta ngremë në nivelin e vendeve të NATO-s

*Për të studiuar në Akademinë e FA aplikuan rreth 600 të rinj e të reja, por vetëm 60 prej tyre u përzgjodhën. Mes fituesve 13 janë vajza*

Bega. Ministria e Arsimit, Rinisë e Sportit u shpreh se ky është një moment shumë i veçantë pasi bëhet fjalë për një institucion prestigjioz, një strukturë e rëndësishme që do përgatisë brezat e ardhshëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. "Çdo studentë, është një aset i së ardhmes në fushën e mbrojtjes. 60-studentëve dhe pedagogëve u uroj shumë suksese dhe mbarësi gjatë vitit akademik. Ky fillim viti akademik, është sfidues, si asnjë vit tjetër më parë për shkak të pandemisë COVID 19. Nuk është aspak e lehtë për mua

sot të uroj vitin e ri akademik në auditorë të zbrazura. Por kjo është një sakrificë që duhet bërë për të mirën e përbashkët. Janë rrethana që nuk duhet t'i shmangim, por t'i përballim me kurajo", - u shpreh ministria Kusho.

"Akademia na krijon sot një mori mundësish që deri dje, as që nuk i mendonim dot, jo vetëm për përgatitjen e kuadrove drejtuese, por edhe për afrimin drejt FA të të rinjve dhe të rejave më të talentuar. Është një gjë t'i kërkosh djemve dhe vajzave që kanë mbaruar shkëlqyer shkollën





e mesme. për t'iu bashkuar FA, dhe është tjetër që t'iu kërkosh atyre që të bëhen pjesë e një universiteti që të jep mundësi që në bazë të meritës të jesh pjesë e strukturës së sigurisë dhe mbrojtjes së vendit tonë me mundësi të pafundme punësi si brenda ashtu dhe jashtë vendit, në sajë të aleancës me NATO-n", - tha Xhaçka. Sipas saj, sfida e vërtetë nis tani sepse sado e vështirë ishte rihapja e akademisë, rikthimi i saj në një histori suksesi nuk do jetë e lehtë, por janë të gjitha mundësitë, të gjithë profesionistët e duhur për ta ngritur atë në nivelin e një akademie të NATO-s", - nënvizoi Xhaçka. "Mbyllja e universitetit të FA ishte një nga gjëmat më të pakuptueshme të tranzicionit. Akademia u mbyll vetëm 1 vit pasi u anëtarësuam në NATO, ndërkohë që rruga e një force moderne dhe profesioniste kalon nga Akademia", - tha ministrja e Mbrojtjes. Ajo falënderoi SHBA, Turqinë, Greqinë, Italinë e Anglinë për ndihmën në arsimim gjatë këtyre viteve dhe shtoi se "armatimet e pajisjet janë pesë me hiç nëse nuk investojmë tek njerëzit tanë. Pas disa vitesh, rihapja e Akademisë së FA do të shihet si një nga momentet kyçe të ringritjes së FA", - përfundoi Xhaçka. Për të studiuar në Akademinë e FA aplikuan rreth 600 të rinj e të reja, por vetëm 60 prej tyre u përzgjedhën. Mes fituesve 13 janë vajza.



BIBLIOTEKA E AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA

## Biblioteka e Akademisë pasurohet me 220 tituj dhe 600 kopje librash

*Shumica e titujve të dhuruar nga Akademia e Shkencave trajtojnë tema historike për popullin tonë dhe gjuhën shqipe*

**B**iblioteka e Akademisë së Forcave të Armatosura pasurohet në prag të nisjes së vitit të ri akademik, i cili pas një shkëputje 10-vjeçare do të presë kadetët për të ndjekur ciklin bachelor për shkencë ushtarake. Akademia e Shkencave dhuroi më 30 tetor 2020, 220 tituj dhe rreth 600 kopje librash, të cilët i shtohen fondit prej 8 mijë titujsh të Bibliotekës së Akademisë së Forcave të Armatosura.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka falenderoi Akademinë e Shkencave dhe kryetarin e saj për këtë kontribut në prag të nisjes së vitit të ri akademik. Sipas saj, pandemia e kohët e vështira, që po jetojmë nuk duhet të jenë pengesë për të orientuar përherë e më shumë brezin e ri dhe oficerët e FA drejt librit e dijes. "Nuk ka investim më të rëndësishëm sesa investim te dija, pavarësisht se sa të mira janë pajisjet apo sa të mëdha janë buxhetet tona.



Nëse nuk kemi një forcë të mirëarsimuar, mirëtrajnuar e profesioniste për t'iu përballur me sfidat e sotme, nuk do t'ia dalim të jemi një vend aleat me të gjitha kapacitetet." - u shpreh ministrja Xhaçka. Kryetari i Akademisë së Shkencave, profesor Skënder Gjinnushi u shpreh se institucioni që ai drejton e ka në politikën e tij që të dhurojë botimet e veta dhe shprehu kënaqësinë e veçantë që këtë kontribut ia dhurojnë, siç u shpreh ai, një institucioni kaq prestigjioz si Akademia e Forcave të Armatosura.

Titujt e dhuruar janë botime të Akademisë së Shkencave dhe do të ndihmojnë në formimin profesional dhe kulturor të ushtarakëve të rinj. Shumica e titujve të dhuruar trajtojnë tema historike për popullin tonë dhe gjuhën shqipe.



# Buxheti i Mbrojtjes 2021

## Rritja 2,7 miliard lekë ose 11,8% më shumë se në vitin 2020

Buxheti për vitin 2021 vazhdon trendin e rritjes ku nëse për vitin 2020, buxheti zinte 1,46 % të Produktit të Brendshëm Bruto, për vitin 2021 ai shkon në 1,5% të PBB

**B**uxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2021 ka një rritje prej rreth 2,7 miliard lekëve, ose 11,8% më shumë se në vitin 2020. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, gjatë një seance dëgjimore në Komisionin Parlamentar për Sigurinë Kombëtare theksoi ditën e mërkurë më 28 tetor 2020, se projekt-buxheti dedikuar Mbrojtjes edhe për vitin e ardhshëm mban ritëm rritës dhe shkon në funksion të forcimit dhe rritjes së kapaciteteve të FA.

“Ky buxhet vazhdon trendin e rritjes si në vlerë nominale ashtu edhe si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Pra, nëse për vitin 2020 kishim një buxhet sa 1,46 % e Produktit të Brendshëm Bruto, për vitin 2021 buxheti shkon në 1,5% të PBB, çka është në përputhje të plotë me objektivat dhe angazhimet tona në Samitin e Uellsit për ta çuar atë në 1,75% në vitin 2022, dhe 1,85% të PBB në buxhetin e vitit 2023”, tha Xhaçka.

Teksa shprehu angazhimin e Shqipërisë në misionet ndërkombëtare, ministria Xhaçka deklaroi se për herë të parë në vendin tonë do të zhvillohet stërvitja më e madhe ushtarake, me pjesëmarrjen e 8 mijë trupave amerikane.

“Stërvitja “Defender-2021”, një stërvitje dypalëshe me SHBA, është e para e këtij lloji në vendin tonë dhe do të marrim pjesë mbi 8.000 trupa amerikane, që do të dislokoen në disa rajone të vendit dhe në disa reparte të Forcave tona të Armatosura”, tha Xhaçka.

Pavarësisht goditjes që ka përjetuar ekonomia gjatë vitit të fundit si pasojë e tërmetit, por edhe e pandemisë, Shqipëria i është përmbajtur angazhimit politik para aleatëve, ku trajtimi i personelit mbetet një ndër prioritetet kryesore.

“Kemi rritur trajtimin financiar përmes rillogaritjes së vështirësive dhe rikthimit të kompensimit të ushqimit për mbi 4 mijë efektive të FA, që u hoq nga Qeveria Berisha në vitin 2013 vetëm pak ditë përpara se të dorëzonte pushtetin”, tha ministria Xhaçka. Buxheti i Mbrojtjes do të përdoret për mbështetjen e personelit; operacionet brenda dhe jashtë vendit dhe emergjencat civile; gatishmëria dhe mirëmbajtja; stërvitjet; arsimimi dhe kualifikimi; strukturat dhe angazhimet ndërkombëtare; modernizimi; infrastruktura etj. Përmes buxhetit të vitit të ardhshëm do të mundësohet që FA të përballojë edhe përgjegjësitë e reja që i kanë kaluar Ministrisë së Mbrojtjes, lidhur me Mbrojtjen Civile.





# Buxheti i Mbrojtjes 2021, ja drejtimet kryesore

**D**ua t'ju prezantoj fare shkurtimisht disa nga momentet kryesore të buxhetit dhe përse unë besoj që ky buxhet, duke pasur parasysh rrethanat e vështira që kemi kaluar e situatën e vështirë ku ndodhemi akoma për shkak të pandemisë, adreson në mënyrë realiste ato që janë prioritetet dhe pritshmëritë, jo vetëm të dikasterit që unë drejtoj, por edhe të aleatëve e partnerëve tanë në NATO.

Për periudhën e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, kërkesat buxhetore të hartuara nga Ministria e Mbrojtjes janë në përputhje me Programet e Mbrojtjes dhe janë produkt i bashkëpunimit të strukturave të FA të të gjithë niveleve. Programimi është në përmbushje të misionit kushtetues të FA dhe mbështetet në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Strategjinë Ushtarake, Planin Afatgjatë të Zhvillimit të FA 2019-2025, Planin e Kapaciteteve Operacionale, kërkesat e Objektivave të Kapaciteteve.

Ajo që dua të theksoj së pari, është që edhe ky buxhet vazhdon trendin e rritjes si në vlerë nominale, ashtu edhe si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Pra, nëse për vitin 2020 kishim një buxhet sa 1,46 % e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), për vitin 2021 buxheti shkon në 1,5% të PBB, çka është në përputhje të plotë me objektivat dhe angazhimet tona në Samitin e Uellsit për ta çuar atë në 1,75% në vitin 2022, dhe 1,85% të PBB në buxhetin e vitit 2023.

Pra, pavarësisht goditjes që ka përjetuar ekonomia gjatë vitit të fundit si pasojë e tërmetit, por edhe e pandemisë, i jemi përmbajtur këtij angazhimi politik, të marrë përpara aleatëve sepse siç jeni në dijeni, ky trend rritës është dakordësuar me aleatët amerikanë dhe NATO, të cilët janë shprehur me vlerësime



Fjala e plotë e ministres së Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka në Komisionin e Sigurisë Kombëtare për Projektbuxhetin e Mbrojtjes për vitin 2021/ e mërkurë 28 tetor 202



maksimale për vullnetin dhe punën konkrete që kemi bërë në këtë drejtim.

Në terma nominalë, buxheti i vitit 2021 ka një rritje me rreth 2,7 miliard lek ose 11,8% krahasuar me planin e vitit 2020. Por sigurisht, fakti që buxheti është rritur tregon vetëm një rën pjesë të historisë, sepse rritja e buxhetit dhe arsyeja përse aleatët këmbëngulin në rritjen e buxhetit për të arritur eventualisht në 2% të PBB, nuk është një qëllim në vetvete. Mënyra sesi shpenzohen dhe produktet për të cilat përdoren këto para është thelbësore. E them këtë, sepse nëse shikojmë historikun e buxheteve të MM, ata ndër ju që kanë kohë në këtë komision besoj janë në dijeni, është e qartë që shpesh herë buxhetet janë përdorur për gjithçka, përveçse për të çuar përpara angazhimet e prioritetet.

Buxheti i Mbrojtjes do të përdoret për mbështetjen e programeve të mbrojtjes të parashikuara për vitet 2021-2023,

për të cilat janë hartuar kërkesat buxhetore si më poshtë:

1. Mbështetja për personelin;
2. Operacionet brenda dhe jashtë vendit dhe emergjencat civile;
3. Gatishmëria dhe mirëmbajtja;
4. Stërvitjet;
5. Arsimitimi dhe kualifikimi;
6. Strukturat dhe angazhimet ndërkombëtare;
7. Modernizimi;
8. Infrastruktura;
9. Mbështetja me mallra e shërbime dhe mbështetja administrative.

Në këtë kuadër Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Buxheti Vjetor i Ministrisë së Mbrojtjes mundëson mbështetjen e kërkesave për modernizim, arritjen dhe ruajtjen e niveleve të planifikuara të operacionalitetit, plotësimin e detyrimeve ndaj Aleancës për mbrojtjen kolektive të përfshirë në Objektivat e kapaciteteve dhe detyrimet në mbështetje të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes në operacione në përbërje të NATO, BE dhe OKB. Për

këtë qëllim kemi bërë prioritizimin e kapaciteteve si dhe kemi përcaktuar nivelet në të cilat duhet të zhvillohet çdo kapacitet, të shoqëruara me nevojat për burime.

Kërkesat prioritare në programet e modernizimit mbështesin projektet kryesore të FA, kryesisht ato të një-sive luftuese, siç janë Batalioni i Dytë i Këmbësorisë, Batalioni i Forcave Speciale apo Batalioni Komando.

Në mënyrë specifike ky projekt buxhet do të shkojë për zërat e mëposhtëme:

### Shpenzimet e Personelit

Në artikullin 600-601 shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore kërkesat buxhetore të strukturave buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes janë në përputhje me tavanet e parashikuara duke mos paraqitur kërkesa buxhetore shtesë për politika të reja. Me buxhetin e akorduar për Ministrinë e Mbrojtjes për këtë zë plotësohen kërkesat buxhetore për numrin e punonjësve të parashikuar për vitet e PBA.

Njëkohësisht ky buxhet që na mundëson ta çojmë përpara e ta konsolidojmë, ka të bëjë me rritjen sa i takon trajtimit të efektivëve tanë dhe edukimin e tyre. Këtu e kam fjalën së pari, për rritjen e trajtimit financiar përmes rillogaritjes së vështirësive dhe rikthimit të kompensimit të ushqimit për mbi 4 mijë efektivë të FA dhe të kompensimit ushqimor që u hoq nga Qeveria Berisha në vitin 2013, vetëm pak ditë përpara se të dorëzonte pushtetin. Këtu gjej rastin, t'i falënderoj kolegët e Komisionit për mbështetjen e tyre për këtë masë shumë të rëndësishme që korrigoji një padrejtësi, që u ishte bërë efektivëve të FA.

### Shpenzimet korrente

Në prioritarizimin e shpenzimeve korrente zërat kryesorë për të cilin janë hartuar kërkesat janë:

- Operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare.

Këto kërkesa mbështesin angazhimin e FA në operacionet brenda dhe jashtë vendit, sipas detyrimeve të deklaruara.

Në kërkesat buxhetore për operacionet jashtë vendit, faktor është numri i personelit të FA i deklaruar në strukturat e NATO dhe strukturat e tjera ndërkombëtare, por ky numër mund të ndryshojë në varësi të zhvillimeve në arenën ndërkombëtare, por, në këtë rast, MM sigurisht që

do të informojë menjëherë strukturat vendimmarrëse.

Shqipëria është një nga vendet që ka ndër kontributet më të larta në misionet e Aleancës duke fituar respektin e aleatëve për kontributin e saj. Ne do të vazhdojmë të japim kontributin tonë në misionet ku jemi aktualisht të pranishëm qoftë në Afganistanin e largët në operacionin e NATO-s "Resolute Support Mission"; në misionin "ALTHEA" në Bosnje-Hercegovinë; në misionin KFOR të NATO-s në Kosovë; në operacionin ushtarak të NATO-s "Enhanced Forward Presence-eFP" në Letoni, në misionin e OKB në Sudanin e Jugut, por do të angazhohemi edhe në dislokime të reja si, në misionin e NATO-s në Irak (kjo në kuadër të Kartës së Adriatikut) apo dhe në Ngushticen e Hormuzit në krah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, angazhim, i



cili është marrë, por për të cilin jemi duke pritur përfundimin e paketës ligjore.

- Krahash misioneve, kemi edhe kërkesat për përfaqësitë/shtabet dhe aktivitetet me NATO duke siguruar mbështetjen e personelit ushtarak e civil të angazhuar në shtabet e NATO-s, Përfaqësitë Ushtarake, atashetë ushtarake dhe strukturat ushtarake rajonale.

Vendi ynë është pjesëmarrës në iniciativat e sigurisë rajonale dhe që prej vitit 2019 ka marrë drejtimin e disa prej tyre, gjë e cila kërkon natyrisht mbështetje me fonde buxhetore. Aktualisht, kemi marrë drejtimin e SEDM-it (Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore) dhe Sekretariatit të SEDM-it si dhe Qendrës për Bashkëpunim dhe Siguri (RACVIAC). Janë angazhime të cilat sigurisht që rrisin reputacionin e Shqipërisë dhe imazhin e saj në sytë e partnerëve dhe aleatëve dhe për të

cilat sigurisht ka shumë konkurrencë mes vendeve pjesëmarrëse. Fakti që Shqipërisë i është besuar drejtimi i këtyre iniciativave është në fakt një tregues i qartë të progresit të madh që ka bërë Shqipëria dhe i besimit që ajo gëzon tashmë mes partnerëve.

- Kërkesat për stërvitje të FA, janë po ashtu një zë shumë i rëndësishëm sepse këto stërvitje janë jetike për rritjen e performancës dhe profesionalizmit të forcave tona.

Ne këtë pike dua të ndaj me ju disa detaje lidhur me një nga stërvitjet më të mëdha, që është zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri. Stërvitja Defender-2021, një stërvitje dypalëshe me SHBA; është e para e këtij lloji në vendin tonë dhe do të marrim pjesë mbi 8.000 trupa amerikane, që do të dislokohen në disa rajone të vendit dhe në disa reparte të Forcave tona të Armatosura. Për më shumë de-

taje, nëse jeni të interesuar, kam në krah dhe shefin e SHPFA, i cili mund të ndalet dhe më teknikisht nga ana operacionale.

- Kërkesat për mbështetjen me shërbime të tjera, ku më të rëndësishmet janë: furnizimi me karburant i strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes, siguracione të ndryshme si për personelin, ashtu dhe për pajisjet e FA, shërbime me të tretë, etj.

- Kërkesat për gatishmërinë dhe mirëmbajtjen, të cilat synojnë rritjen e nivelit të gatishmërisë së strukturave të FA dhe rritjen e nivelit të mirëmbajtjes së sistemeve, pajisjeve dhe mjeteve për të mbajtur dhe aritur kapacitetet operacionale të kërkuara. Në këtë kontekst, këtë vit do të kemi një risi të shtuar, atë të pjesëmarrjes së gjigandit të industrisë ushtarake amerikane Lockheed Martin, si në Sistemin e Mirëmbajtjes së Vëzhgimit të Hapë-

sirës Detare, ashtu edhe atë të implementimit të Radarit të Midës për Forcën Ajrore.

### **Shpenzimet për Investime**

Kërkesat për investime janë hartuar në mbështetje të PAZH, duke marrë në konsideratë projektet në vazhdim, projektet me kërkesa operacionale të miratuara, propozimet teknike dhe detyrat e projektimit në funksion të modernizimit të FA si dhe ndërhyrjet infrastrukturore më të nevojshme për njësitë e FA. Objektivat kryesorë të implementimit të programeve të investimeve për vitet e PBA janë:

- Implementimi i Objektiveve të Kapaciteteve dhe përbushja e deklarimeve dhe detyrimeve ndaj NATO-s;
- Mbështetja për projektet kryesore të modernizimit të FA;
- Mbështetja për rritjen e kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile;
- Përmirësimi i infrastrukturës së njësive e reparteve sipas standardeve të NATO-s.

Pajisjet, baza materiale, infrastruktura edhe pse shumë të rëndësishme, janë vetëm një pjesë e investimeve të domosdoshme që duhet të ndodhin.

Po kështu duhet të ve në dukje përpjekjen e madhe që është bërë për edukimin dhe arsimimin e ushtarakëve, ku Buxheti 2021 na lejon zhvillimin dhe integrimin e mëtejshëm të sistemit arsimor, plotësimin e nevojave materiale e didaktike, zhvillimin e planeve dhe programeve të arsimimit, por edhe stërvitjet, kryerjen e specializimeve, analizave, studimeve e kështu me radhë.

Në programin për arsimin kemi kërkuar mbështetje për projektin "Infrastrukturë, përmirësim kushtesh dhe pajisje për ngritjen e Akademisë së FA", si një nga objektivat kryesorë të MM për rihapjen e sistemit arsimor bazë në FA. Pas më shumë se 10 vitesh, tashmë dhe Forca jonë e Armatosur si çdo vend anëtar i NATO-s do të ketë akademinë e saj ku do të përgatiten oficerët e rinj.

Jam krenarë që pas një procesi të gjatë ia arritëm së bashku dhe me mbështetjen e qeverisë hapjen e kësaj akademie për oficeret tanë. Dhe në këtë pikë, dua ta theksoj, që unë besoj dhe e gjithë trupa drejtuese e FA beson, që hapja e programit bachelor në Akademinë e FA këtë vit, shënon vërtet një moment shumë të rëndësishëm në

procesin e modernizimit të FA; por edhe më shumë se kaq, ngre themelet e një sistemi meritokratik dhe një sistemi karriere, që do të na lejojë jo vetëm të afrojmë të rinj e të reja të talentuara, por edhe të krijojmë një trup oficerësh e drejtuesish të standardeve të NATO.

### **Kërkesat për modernizim**

Projektet e modernizimit kanë një impakt të madh në kërkesat buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes. Prioritet janë sigurimi i armatimit të lehtë dhe municionit të nevojshëm për FA, pajisjet e komunikimit taktik me radio (një-kanalësh) për grupbatalionin, Sistemi i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore, sisteme komunikimi (tokë-ajër-tokë), projekte të përbashkëta me NATO për sistemet e komandim-kontrollit ajror, sistemet e vetëmbrojtjes së helikopterëve, rinovimi i infrastrukturës dhe sistemit të komunikimit detare. etj.

### **Kërkesa për infrastrukturën**

Prioritet janë ndërhyrjet infrastrukturore në funksion të krijimit të kushteve optimale për punë të ushtarakëve, si dhe mbështetja e projektit të garantuar nga NATO për ringritjen e Bazës Ajrore të Kuçovës.

Së fundi, ky buxhet na mundëson të përballojmë përgjegjësitë e reja, që i kanë kaluar Ministrisë së Mbrojtjes, ku e kam fjalën padyshim për Mbrojtjen Civile, e cila, siç jemi dëshmitarë të gjithë, gjatë vitit të fundit ka qenë një nga përgjegjësitë më të rëndësishme e më jetike që ka zbatuar Ministria e Mbrojtjes.

Ka kaluar, vetëm diçka, më shumë se një vit, që nga miratimi i Ligjit për Mbrojtjen Civile, por gjatë këtij viti është bërë një punë vërtet e jashtëzakonshme. Duke filluar që nga ngritja e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e cila nga një drejtori me 7 persona, që bënte vetëm stacionin telefonik, sot është kthyer në një agjenci, që koordinon punën mes të gjitha zyrave të EC në rang bashkie e prefekturë; komunikon dhe koordinon nevojat me strukturat respektive të EC në Bashkimin Europian; monitoron respektimin e ligjit nga strukturat e linjës. Duke vazhduar me rritjen e dhe modernizimin e kapaciteteve reaguese të Forcave të Armatosura, të specializuara për rastet e emergjencave, ku falë bashkëpunimit me aleatët e NATO (SHBA, Turqia etj), sot FA janë të pajisura me uniformat dhe

mjetet bashkëkohore të nevojshme në operacionet në mbështetje të pushtetit vendor dhe popullatës në raste tërmetesh; përmbytjesh, zjarresh etj. E duke vazhduar më tej me hartimin e studimeve e strategjive për zvogëlimin e riskut e kështu me radhë. Të gjitha këto, në një kohë kur kësaj strukture dhe FA i është dashur të përballojë emergjencat e situata që shkojnë që nga Tërmeti i 26 Nëntorit, zjarret, rehabilitimi i argjinaturave e sigurisht, përfshirja në përballimin e pandemisë.

Ky buxhet, na lejon të jemi të përgatitur për çdo eventualitet, që mund të ndodhë gjatë vitit 2021. Por na lejon edhe që të forcojmë e të rrisim më tej kapacitetet, pasi viti i fundit ishte treguesi më i mirë i rëndësisë së jashtëzakonshme që ka marrë sot kjo përgjegjësi e FA, për të garantuar jetët, shëndetin dhe pronat e qytetarëve. Jo vetëm kaq, por ky buxhet, na lejon që të ecim përpara drejt përbushjes së objektivit tonë madhor, për ta integruar Agjencinë e Mbrojtjes Civile në strukturat europiane për përballimin e emergjencave. Unë jam e vetëdijshme që nevojat e FA janë shumë të mëdha. E kam shumë të qartë se çfarë do të thotë konkretisht arritje e standardeve të NATO dhe bashkë me ekipin e dikasterit që drejtoj dhe drejtuesit e FA kemi një vizion të qartë të procesit të transformimit e modernizimit, që nevojitet për të arritur këtë objektiv madhor. Dhe sigurisht që, si çdo njeri që punon e i përkushtohet një projekti edhe unë e gjithë ekipi do të kishim dashur shumë që ky objektiv të përmbushej që nesër. Ama, jemi njerëz me këmbë në tokë, që dimë të bëjmë dallimin mes dëshirave e ëndrrave dhe mundësive reale, siç e bëjnë në fakt të gjithë ministrat e mbrojtjes e drejtuesit ushtarakë qoftë edhe në vendet më të pasura e më të zhvilluara. Dhe mund të them pa asnjë hezitim, që ky buxhet na lejon të çojmë përpara prioritetet tona, por edhe të përbushim angazhimet tona kundrejt aleatëve. E di që kjo s'ka qenë e lehtë në një kohë si kjo ku jetojmë, por besoj që ky është një mesazh shumë i qartë i seriozitetit dhe vendosmërisë së qeverisë shqiptare për të respektuar deri në fund çdo angazhim ndërkombëtar kundrejt NATO dhe partnerëve tanë amerikanë dhe për të kontribuar brenda të gjithë mundësive të saj si një partner dinjitoz dhe i besueshëm dhe si një faktor stabiliteti e sigurie në rajonin.





**Kuvendi i Shqipërisë miraton marrëveshjen midis KM të RSH dhe AMP të NATO-s**

# Baza e Kuçovës: Projekti dhe investimi realizohen nga Programi i Investimeve të NATO-s

**D**itën e enjte, më 22 tetor 2020, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar projektligjin “Marrëveshja për mbështetje teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s për realizimin e Projekteve të Kuçovës, të financuara nga Programi i Investimeve të NATO-s për Sigurinë, vitet 2019-2022”.

Për mbrojtjen e këtij projektligji ka folur në parlament, ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka e cila tha se “projektligji i hap rrugë zbatimit të projektit për modernizimin e Bazës së Kuçovës dhe shndërrimin e saj në një bazë ajrore taktike të NATO”.

“Nuk ka asnjë dyshim, tha Xhaçka, që ndërtimi i kësaj baze, punimet për të cilën do të fillojnë brenda një kohe shumë të shkurtër, ka një rëndësi të jashtëzakonshme për ne”. Lidhur me rëndësinë e kësaj Baze Ushtarake, ministrja ka evidentuar tre faktore: “Së pari, sepse kjo bazë e vendos



Miratohet projektligji “Marrëveshja për mbështetje teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s për realizimin e Projekteve të Kuçovës, të financuara nga Programi i Investimeve të NATO-s për Sigurinë, vitet 2019-2022”

Shqipërinë në hartën e interesave strategjike të NATO-s. Vendi merr një rëndësi strategjike që nuk e ka pasur më prej shumë e shumë dekadash. Dhe dua t’ju kujtoj po ashtu që ky është jo vetëm investimi më i madh por edhe e vetmja bazë ajrore e NATO-s në rajonin tonë. Në terma ushtarakë, Baza e Kuçovës do të jetë një Bazë Taktike e Dislokueshme, që do të ketë të gjithë infrastrukturën dhe kapacitetet e nevojshme për të mbështetur 24 orë në 7 ditë të javës, misionet NATO-s, qofshin këto misione stërvitore në kohë paqeje, apo misione luftarake në kohë krize. Më konkretisht baza do të mbështesë dislokimin e 6 avionëve luftarakë

taktikë dhe të avionëve të transportit. Së dyti, funksionimi i Bazës së Kuçovës do të ketë një ndikim të rëndësishëm përsa i përket modernizimit dhe fuqizimit të Forcave Ajrore Shqiptare. Ne kemi hedhur disa hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, në bashkëpunim sigurisht me aleatët, duke ngritur sistemin e vëzhgimit të hapësirës ajrore, në bashkëpunim me Lockheed Martin, gjigandin e industrisë ushtarake botërore dhe amerikane, apo duke i shtuar flotës sonë, disa helikopterë Blackhawk, që do të na lejojnë dalëngadalë të hedhim disa hapa të rëndësishëm drejt ringritjes së Forcës Ajrore, e cila më shumë se çdo forcë tjetër

e ushtrisë tonë, ka vuajtur nga degradimi dhe shkatërrimi. Falë Bazës së Kuçovës, tashmë forcat tona, do të kenë mundësi shumë më të mëdha bashkëpunimi dypalësh apo trajnimi, çka më parë ka qenë thjesht e pamundur. Së treti, përtej dimensionit ushtarak dhe strategjik, kjo bazë do të ketë edhe një impakt shumë të madh në ekonominë dhe zhvillimin e të gjithë zonës së Kuçovës. Dhe nuk e kam fjalën thjesht dhe vetëm për investimin e fazës së parë, që arrin deri në 50 milionë Euro, dhe do të krijojë mundësi punësimi dhe ekonomi në mbarë zonën e Kuçovës por edhe më gjerë. E kam fjalën edhe për impaktin që kjo bazë do të ketë në planin afatgjatë, falë qarkullimit të efektivëve dhe personelit mbështetës, që do të vendosen aty duke krijuar një kërkesë të vazhdueshme për shërbime, produkte e kështu me radhë”.

“Por personalisht, vazhdoi Xhaçka, ajo që më bën realisht krenare, është fakti që aleatët, zgjedhën Shqipërinë për ndërtimin e një baze ajrore, siç e thash, e vetmja në rajonin tone”.

“E di, tha ajo, që gjërat harrohen shpejt, por besoj që e mbani mend që deri 7 apo 8 vjet më parë, FA shqiptare përmendeshin ende për ryshfetet që u kërkoheshin ushtarakëve në misione, për dyshime për nxjerrje sekretesh apo për kërkimet e thesareve me mjetet e ushtrisë. E pra besoni që në atë kohë Shqipëria mund të kishte qenë një opsion i besueshëm për të bërë një investim strategjik të kësaj natyre?”

Unë mendoj jo, por besoj që fakti që për ndërtimin e kësaj baze u zgjedh Shqipëria, flet shumë qartë për standardin që kanë arritur sot FA dhe për besimin që kanë sot aleatët tek Shqipëria. Dhe dua ta theksoj, që edhe pse ky është investimi më i madh e më spektakolar, ky nuk është aspak investimi i vetëm që kanë bërë aleatët tek FA sepse gjatë dy viteve të fundit kemi parë realisht një nivel rekord mbështetje, sidomos nga aleatët tanë amerikanë, por jo vetëm. Arsyeja për këtë është e thjeshtë. Aleatët tanë e shohin, ashtu siç e shohin edhe të gjithë efektivët e FA, që sot ushtria shqiptare ka hedhur hapa të

jashtëzakonshëm drejt modernizimit dhe profesionalizimit, dhe operon me standarde të krahasueshme me ato të aleatëve tanë.

Dhe këtë nuk e them unë, por e thonë aleatët. E thonë për kontingjentet shqiptare në Afganistan, në Kosovë, në Mali. E thonë për kontributin tonë në Irak apo në Letoni.

Baza e Kuçovës është një projekt afatgjatë, ndikimi i së cilës do të

dhe ku, po investohet si asnjëherë më parë tek ata që janë çelësi i vërtetë i suksesit të rindërtimit të FA, që janë burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat që mbajnë veshur uniformën e FARSH.

Sigurisht që nuk dua të mohoj që ka ende shumë dhe shumë punë për të bërë për të rindërtuar FA dhe për ta çuar atë plotësisht në nivelin që i takon ushtrisë së një vendi anëtar të



ndihet për shumë e shumë vite në të ardhmen. Por po kaq afatgjatë është edhe transformimi që po ndodh sot në FA ku sot po konsolidohet një sistem karriere meritokratik, ku po investohet tek arsimit dhe dija si kurrë më parë në 30 vitet e fundit,

NATO-s. Por është e qartë që tanimë FA janë në një proces reformimi dhe modernizimi që po krijon një momentum të mirë që unë besoj që do të përshpejtohet edhe më shumë falë investimeve të rëndësishme strategjike si kjo e Bazës së Kuçovës”.

**N**ë takimin e dy qeverive, të Shqipërisë dhe Kosovës, zhvilluar më 2 tetor 2020, në Tiranë, midis 14 marrvëshjeve, ishte edhe nënshkrimi i Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Ne praninë e dy kryeministrave Rama dhe Hoti, marrëveshja u firmos nga Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Agim Veliu. Marrëveshja në fjalë, do t'i përcaktoj format e bashkëpunimit, procedurat për dhënien e ndihmës, procedurat e kalimit kufitar dhe rregullat për qëndrimin e ekipeve të shpëtimit, kalimin kufitar të pajisjeve dhe artikujve të ndihmës, strehimit dhe ndihma e të zhvendosurve, përdorimin e Avionëve si dhe bashkërendimin dhe menaxhimin e operacioneve të ndihmës ndaj fatkeqësisë, etj.

Ministrja e mbrojtjes Olta Xhaçka tha se "Marrëveshja që firmosim sot mes dy Ministrive të Mbrojtjes për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera vjen si produkt i dëshirës sonë të dyanshme dhe i përputhjes së objektit të dy qeverive, për të forcuar bashkëpunimin për Mbrojtjen Civile, por mbi të gjitha është një marrëveshje, e cila do t'i bëjë qytetarët shqiptarë në të dy anët e kufirit më të sigurt përballë rreziqeve dhe kërcënimeve nga emergjencat, të cilat siç jemi dëshmitarë të gjithë janë kthyer në një sfidë të vërtetë gjatë viteve të fundit.

Unë besoj që bashkëpunimi dhe krijimi i sinergjive mes Shqipërisë e Kosovës është i natyrshëm dhe i dëshiruar në çdo fushë e sektor, por Emergjencat Civile, janë padyshim një fushë ku ky bashkëpunim është më i natyrshëm dhe më i lehtë për t'u realizuar se kudo tjetër. Kjo jo thjesht për shkak të interesit të përbashkët dhe përfitimeve të dukshme që kemi duke bashkuar forcat, apo të faktit që sfidat me të cilat përballemi për sa i përket menaxhimit të fatkeqësive natyrore, apo atyre të shkaktuara nga dora e njeriut, janë shumë të ngjashme,

Firmoset marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për bashkëpunim e ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera



por mbi të gjitha sepse është një bashkëpunim që ngrihet mbi një traditë të konsoliduar e fisnike mes shqiptarëve këtej e andej kufirit për të ndihmuar njëri - tjetrin në raste vështirësish e rreziqesh. Tërmeti i 26 Nëntorit ishte veç shembulli më i fundit i kësaj tradite, kur Kosova ishte e para që nxitoi të na ndihmonte në momentin tonë të tragjedisë duke dërguar ekipe shpëtimi që në orët e para të asaj nate.

Unë jam shumë optimiste që ne

do të dimë të bashkëpunojmë në mënyrë efikase në përputhje me këtë marrëveshje që skicon kuadrin e përgjithshëm të bashkëpunimit në fushën e përballimit të emergjencave, duke filluar me planifikimin e masave parandaluese, ofrimin e ndihmës së ndërsjellë në kërkim-shpëtim dhe eliminimin e pasojave, apo në bashkëpunimin për rritjen e kapaciteteve logjistike, njerëzore e institucionale të strukturave të Mbrojtjes Civile.





Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka-Ministri i Punëve të Brendshme Agim Veliu

## Do përdoren edhe avionë në përballimin e fatkeqësive natyrore

Më konkretisht, do të bashkëpunojmë ngushtë në dhënien e ndihmës, shkëmbimin e informacionit apo ekspertizës, përgatitjen e programeve të përbashkëta, kërkimin shkencor, furnizimin e pajisjes e ekipeve në terren, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, në planifikimin e përbashkët, e kështu me radhë.

Shqipëria ka filluar tashmë një proces realisht ambicioz modernizimi e transformimi të Emergjencave

Civile, duke kaluar një ligj të hartuar me mbështetjen e partnerëve. Kemi hedhur hapa të mëdha drejt modernizimit jo vetëm të strukturave, përmes ngritjes së Agjencisë së Mbrojtjes Civile, por edhe të bazës materiale, pajisjeve, mjeteve. Por mbi të gjitha kemi bërë shumë progres në transformimin e qasjes ndaj rreziqeve natyrore duke e kaluar fokusin nga reagimi tek parandalimi. Situata e shkaktuar nga tërmetet e vitit që shkoi, nga zjarret e shumta

që kemi përjetuar gjatë këtij viti, e padyshim edhe nga pandemia na ka detyruar t'i përshpejtojmë planet e afatet, duke ia dalë që në vetëm një vit të arrijmë një nivel gatishmërie e operativiteti, që në planet fillestare do të kishte kërkuar së paku 4 apo 5 vjet, por sigurisht kemi shumë rrugë për të bërë akoma derisa struktura për të cilën po punojmë të jetë e standardeve që kërkohen për t'u anëtarësuar në Mekanizmin e BE për Mbrojtjen Civile".

## Takimi i përvitshëm i Ministrave të Mbrojtjes së Europës Juglindore

# Forca Shumëkombëshe e Europës Juglindore, kontribuon në sigurinë dhe stabilitetin rajonal

Në datën 14 tetor 2020, në cilësinë e vendit që mban kryesimin e Sekretariatit të Inicativës të SEDM (South-East Europe Defence Ministerial), në Ministrinë e Mbrojtjes, u zhvillua Takimi i përvitshëm i Ministrave të Mbrojtjes së Europës Juglindore, i cili u zhvillua nëpërmjet video-konferencës nëpërmjet portalit të SEDM.

Me pjesëmarrjen e 13 vendeve anëtare, komandantit të Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse e Europës Juglindore (SEEBRIG) si dhe përfaqësues të lartë nga organizata të tjera ndërkombëtare dhe rajonale si UNDP SEESAC, RCC dhe RACVIAC, ky takim u drejtua nga zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, në cilësinë e kryetarit të Sekretariatit të SEDM.

Kryetari i Sekretariatit të SEDM, z. Koçi u shpreh në fillim të këtij takimi lidhur me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe theksoi përkushtimin e vendeve të rajonit për të forcuar më tej efektivitetin dhe efikasitetin e kësaj iniciative përmes një bashkëpunimi të shtuar midis vendeve anëtare në këtë situatë të vështirë.

Ai prezantoi projektet dhe aktivitetet e zhvilluara me sukses gjatë kryesimit të Inicativës së SEDM nga vendi ynë që nga ministeriali i vjetërshëm me fokusin kryesor promovimin e sigurisë dhe mbrojtjes.

Ai nënvizoi më tej faktin se Iniciativa e MPFSEE/Forca Shumëkombëshe Paqeruajtëse e Europës Juglindore (SEEBRIG) është një histori suksesi, pasi ka kontribuar shumë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal, në besimin reciprok dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis vendeve të Europës Juglindore.

Komandanti i Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse e Europës Juglindore (SEEBRIG) prezantoi në detaje aktivitetet e zhvilluara nga brigada për vitin 2020 si dhe analizoi zhvillimin e kapaciteteve dhe angazhimet e ardhshme të SEEBRIG.

Pjesëmarrësit mirëpritën arritjet e SEEBRIG dhe konfirmuan kontributin e kësaj brigade për sigurinë dhe stabilitetin rajonal, duke u shndërruar

*Me pjesëmarrjen e 13 vendeve anëtare dhe përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare si UNDP SEESAC, RCC dhe RACVIAC, ky takim u drejtua nga zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, në cilësinë e kryetarit të Sekretariatit të SEDM*

ruar në një platformë unike ushtarake për bashkëpunim dhe training të ndërsjelltë.

Më tej, Ministeriali vijoi me pozicionet e vendeve mbi detyrimet e kësaj iniciative në të ardhmen dhe mbi angazhimin e përbashkët për promovimin e sigurisë, paqes dhe stabilitetit në rajon.

Si një nga prioritetet kryesore të Inicativës u thekusa nga të gjitha vendet anëtare angazhimi për

forcimin e fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të rajonit si dhe bashkëpunimi në kuadër të trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Vendet anëtare të SEDM konfirmuan zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në nivel politik dhe ndërqeveritar nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta të SEDM.

Në takim u miratuan disa dokumente lidhur me projektet në kuadër



të SEDM, që lidhen me ndërlihdjen e spitaleve ushtarake (Interconnection of Military Hospitals Project), Portalin e Iniciativës së SEDM (SEDM Portal) dhe u aprovuan Plani Vjetor dhe Buxheti i Brigadës së SEEBRIG për vitin 2021, të cilat do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe projekteve gjatë vitit të ardhshëm. Takimi i Ministerialit u mbyll me miratimin e Deklaratës së Përbashkët (Joint Statement) të ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Europës Juglindore. Ky ishte Ministeriali i dytë i SEDM-it i drejtuar nga Shqipëria, gjatë kryesimit 2019-2021.

SEDM është një proces i bashkëpunimit midis Ministrive të Mbrojtjes të vendeve të EJT. Thelbi i procesit është të forcojë bashkëpunimin politiko-ushtarak në rajon, në mënyrë që të përmirësojë stabilitetin dhe sigurinë në EJT, të promovojë proceset integruese Euro-Atlantike të vendeve anëtare të SEDM dhe të forcojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare (OKB, BE, NATO dhe OSBE). Aktualisht (2019-2021) organet e koordinimit të SEDM kryesohen nga Republika e Shqipërisë. Një nga projektet më të rëndësishme të procesit SEDM është Brigada e Evropës Juglindore (SEEBRIG), selia e së cilës nga gushti, 2020 deri në gusht, 2026 ka vendndodhjen e përhershme në Kumanovë, Republikën e Maqedonisë së Veriut.

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ-KOLONEL FABRICE DUDA

## Bashkëpunimi ushtarak me Francën do të vazhdojë

*Gjeneralmajor Bajram Begaj, zhvilloi një takim me atasheun ushtarak të Republikës së Francës së akredituar në vendin tonë, kolonel Fabrice Duda*

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, zhvilloi me 30 tetor 2020, një takim me atasheun ushtarak të Republikës së Francës së akredituar në vendin tonë, kolonel Fabrice Duda.

Takimi u zhvillua virtualisht nëpërmjet platformave online, në kuadër të masave anti-COVID19

Gjeneralmajor Begaj vlerësoi bashkëpunimin dypalësh të deritanishëm midis Shqipërisë dhe Francës në fushën e



Mbrojtjes, duke falenderuar për mbështetjen që Franca ka dhënë në modernizimin e FARSH me helikopterë dhe trajnimin e personelit me kurset e ofruara.

Nga ana e tij, atasheu ushtarak francez, Kolonel Duda, vlerësoi rolin dhe kontributin e FARSH në misionet ushtarake ku dy vendet kanë trupa të përbashkëta, kontributin e Shqipërisë me personel në Korpusin e Reagimit të Shpejtë (RRC-FRA) në Lille që prej vitit 2015, si dhe bisedimet midis shtabeve respektive të dy vendeve.

Gjithashtu gjatë takimit gjeneralmajor, Prof,Asoc, Begaj pasi shprehu ngushëllimet për humbjet tragjike të jetëve të pafajshme nga sulmet terroriste të ditëve të fundit në Francë, e siguroi atë se FARSH solidarizohen dhe qëndrojnë krahas kolegëve të tyre Francezë.

Në përfundim të takimit, të dy bashkëbiseduesit ranë në dakortësi për vijimin dhe rritjen e bashkëpunimit në fusha specifike me interes të përbashkët.





# Ministrja Xhaçka: Stafeta e komandës së Forcës Tokësore kalon në duar të sigurta

**F**orca Tokësore nga data 12 tetor 2020 ka një komandant të ri. Gjeneral brigade Arben Kingji u prezantua në një ceremoni të posaçme nga ministrja Olta Xhaçka dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj. Gjeneral brigade Arben Kingji u emërua komandant i Forcës Tokësore me dekret nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, sh.t.z. Ilir Meta, Nr. i Dekreti 11573, datë 2 Tetor 2020.

Në dekretin, përkatëse thuhet se: "Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 169, pika 3, të Kushtetutës, të nenit 9, pika 3, germa "c", e ligjit nr.64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes me nr. prot. 4264/1, datë 01.10.2020, Dekretoj, Gjeneral brigade Arben Voke Kingji, me detyrë Komandant i Batalionit të Mbështetjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, emërohet "Komandant" i Forcës Tokësore".

Në ceremoninë për fillimin e detyrës, ministrja Xhaçka e konsideroi një moment shumë të rëndësishëm ndërrimin e komandantit të komponentit më të madh të Forcave tona të Armatosura, duke e vlerësuar gjeneral brigade Kingjin për aftësitë



Gjeneral brigade Arben Kingji zëvendëson në këtë detyrë gjeneral brigade Albert Mullai, i cili shërbeu në këtë detyrë që nga muaji shkurt i vitit të kaluar.



dhe përvojën e tij. "Unë nuk kam dyshim që sot stafeta e komandës së Forcës Tokësore kalon sot në duart të sigurta. Tek një njeri që do dijë të çojë përpara e të zhvillojë më shumë atë që kemi arritur të ndërtojmë deri më sot. Stafeta e drejtimit të Forcës Tokësore i kalon sot një ushtaraku të kalibrit të gjeneral Kingjit, nga një tjetër ushtarak me vlera e shumë arritje, siç është gjeneral Mullai." - u shpreh Xhaçka.

Më tej, ministrja Xhaçka e vuri theksin te sistemi i meritokracisë

i vendosur rishtaz në Forcat e Armatosura, pa harruar përmirësimin e trajtimit financiar të ushtarakëve dhe modernizimin e strukturave me mjete, pajisje dhe armatim. "Emërimi i komandantit të ri, është një sinjal i qartë i filozofisë mbi të cilën funksionojnë sot Forcat e Armatosura. Emërime larg miqve, politikës e tarafeve, por thjesht e vetëm mbi bazën e meritokracisë. Kemi ende shumë punë përpara, por mund të ndihemi mirë të gjithë për atë që kemi arritur ndërkaq. Duke filluar nga rritja e trajtimit financiar për vështirësinë e punës, apo rikthimi i kompensimit për ushqimin, kompletimi me pajisje individuale të standardizuara të ushtarit, apo certifikimi nga NATO i Grup Batalionit të Këmbësorisë dhe Kompanisë së Dytë të Batalionit Komando. Zhvillime që kanë ardhur në kontekstin e një sërë punësh të mira e zhvillimesh që kanë prekur çdo komponent të FA."

Gjeneral brigade Arben Kingji zëvendëson në këtë detyrë gjeneral brigade Albert Mullai, i cili shërbeu në këtë detyrë që nga muaji shkurt i vitit të kaluar.





**Plotësohet një vakum në komandën e Forcës Detare**

# Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia prezantohet në krye të Flotës shqiptare

**P**as më shumë se një viti, Forca Detare ka komandantin e saj të ri. Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia u prezantua me 16 tetor 2020, në krye të Flotës shqiptare nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Ministrja Xhaçka e konsideroi gjeneral brigade Xhebexhian ushtarakun e duhur në krye të Forcës Detare, i cili do të ndihmojë në modernizimin dhe transformimin e kësaj force. "Jam e lumtur, që më në fund po plotësojmë një vakum në komandën e Forcës Detare duke i dhënë kësaj force jo thjesht një komandant, por një nga efektivistët më të talentuar. Unë jam shumë e sigurt, që gjeneral Xhebexhia ka jo vetëm formimin, por edhe vizionin e duhur për të vënë në lëvizje në këtë forcë të njëjtin proces modernizimi e profesionalizimi që tashmë është në rrugën e duhur në mbarë FA.

FA po përjetojnë sot transformimin më të thellë në tri dekadat e fundit. Është një transformim që ka prekur e po prek çdo element të FA, por që kryefjalë të tij ka pasur investimin tek burimet njerëzore, tek djemtë e vajzat e burrat e gratë që mbajnë sot uniformën e Forcës Detare, Tokësore e Ajrore. Është një investim që ka ecur në paralel në disa drejtime. Vetëm prej pak ditësh ka



Xhaçka: "Gjeneral Xhebexhia ka jo vetëm formimin, por edhe vizionin e duhur për të vënë në lëvizje në këtë forcë të njëjtin proces modernizimi e profesionalizimi që tashmë është në rrugën e duhur në mbarë FA"

filluar puna për të ngritur sistemin e ri të vëzhgimit detar, ndërkohë që po punohet po ashtu edhe për pajisjen me armatime të anijeve të modernizuara të klasit Iliria. Janë këto investime që i kanë lejuar FD të kryejë me sukses disa misione deri pak vite më parë të paimagjineshme, siç ishte ai në detin Egje." - theksoi ministrja Xhaçka.

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia deri tani ka shërbyer si zëvendës përfaqësues ushtarak i Republikës së Shqipërisë në NATO, atashë ushtarak në Mbretërinë e Belgjikës dhe jorezident në Republikën e Francës.

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia është një ushtarak me një karrierë të shkëlqyer kudo ku ka shërbyer. Ai ka përfunduar Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes. Ndërsa në 2006 - 2007 ka qenë oficer koordinator, pranë Komandës Qendrore Amerikane Tampa-Florida USA. Ai ka ushtruar edhe detyra si Zëvendëskomandant i Qendrës së Radio-Zbulimit, nënkolonel, oficer Shtabi për

Inteligjencën, Përfaqësia Ushtarake - Bruksel. Ai ka marrë pjesë në disa misione ndërkombëtare si: stërvitja "Rescuer", Maqedoni; oficer koordinator "Rescuer", Maqedoni; misioni i SFOR-it në Bosnje-Hercegovinë; operacioni "Liria Irakut" (C-2 ne CJTF-7) në Bagdad.

Në formimin e tij, tashmë gjeneral brigade Ilir Xhebexhia numëron edhe një sërë kursesh në Turqi, Gjermani, Greqi, Holandë. Gjatë karrierës së tij, gjeneral brigade Xhebexhia është vlerësuar me disa dekorata, përfshirë: "Medalja e NATO-s për Misionin e Paqeruajtjes" 1998, dhënë nga sekretari i Përgjithshëm i NATO. Ai botoi dy libra, "Liria e Irakut" në 2006 dhe "Evropa Jug-Lindore Proceset Integruese" në 2007 dhe bashkëautor në disa botime të tjera. Kolonel Ilir Xhebexhia aktualisht mban detyrën e zëvendës përfaqësuesit ushtarak në NATO, atashë ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jorezident në Francë, në Përfaqësitë Ushtarake Jashtë Vendit.



## FA po bëhet udhëheqëse në menaxhimin e lëndëve shpërthyesë

Ushtria shqiptare po bëhet udhëheqëse në menaxhimin e sigurt të lëndëve shpërthyesë.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës bëri të ditur me 27 tetor 2020 se, "organizata Jofitimprurëse e Shteteve të Bashkuara Golden West, e vetmja organizatë jofitimprurëse amerikane e specializuar në asgjësimin e lëndëve shpërthyesë dhe menaxhimin e rezervave të armëve, ofroi trajnim të rëndësishëm udhëheqjeje për Forcat e Armatosura Shqiptare javën e kaluar". Ambasada e SHBA thekson se, "ky trajnim u financua nga Komanda Europiane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe tregon se si ushtria shqiptare po bëhet udhëheqëse në menaxhimin e sigurt të lëndëve shpërthyesë".

Organizata amerikane "Golden West" e specializuar në asgjësimin e lëndëve shpërthyesë trajnon ushtarakët shqiptarë



### Vau i Dejës, Shkodër

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi me 23 tetor një vizitë njohëse në batalionin e parë të këmbësorisë në Vaun e Dejës, Shkodër. Fillimisht gjeneral Kingji nëpërmjet një prezantimi, u njoh me misionin, detyrat dhe problematikat kryesore, me të cilat hasen efektivat e b1k gjatë punës së tyre të përditshme.

Më pas, i shoqëruar nga komandanti i b1k, nënkolonel Ali Mali, gjeneral Kingji vizitoi mjediset e punës, ambientet stërvitore dhe punimet që po kryhen për ndërtimin e poligonit të ri si dhe ambientet e jetesës së personelit të batalionit I-rë të këmbësorisë. Në përfundim të kësaj vizite Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, falenderoi efektivat e këtij reparti për punën e deritanishme si dhe vazhdimin e punës për an-

## Gjeneral brigade Arben Kingji në batalionin e I-rë të këmbësorisë



gazhimet, që e presin këtë repart për të ardhmen. Ai i siguroi ata se kujdesi për krijimin e kushteve optimale të punës si dhe mbështetja për këtë repart, do të jetë gjithmonë në fokus të pu-

nës së tij. Vizita e Komandantit të Forcës Tokësore në batalionin e I-rë të këmbësorisë vjen në kuadër të njohjes dhe prezantimit me personelin e reparteve vartës të Forcës Tokësore.



**N**ë garnizonin e Zall-Herrit u zhvillua ditën e hënë më 19 tetor 2020, ceremonia e marrjes së detyrës së komandantit të Batalionit II të Këmbësorisë të Forcës Tokësore (b2k), nënkolonel Dritan Muka. Në ceremoni ishin të pranishëm: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, përfaqësues nga Shtabi i Forcës Tokësore, të ftuar dhe pjesëtarë të Batalionit II të Këmbësorisë.

Aktiviteti filloi me fjalën përshëndetëse të nënkolonel Nazmi Hoxha, ish-komandant i b2k. Në fjalën e tij, kolonel Hoxha fillimisht solli emocionet dhe vështirësitë e përjetuara gjatë kohës së drejtimit të këtij batalioni dhe sidomos gjatë tërmetit të 26 Nëntorit dhe periudhës së pandemisë. Nënkolonel Hoxha, shprehu mirënjohjen e tij për të gjithë personelin që ai drejtoi, për sakrificën dhe mundin e tyre gjatë kohës që punuan së bashku.

Duke i uruar sukses komandantit të ri të b2k, nënkolonel Mukës, ai u shpreh i bindur se komandanti i ri në këtë detyrë, do të dijë t'i çojë më lart standartet e arritura.

Ndërkohë, nga ana e tij komandanti i sapoemëruar nënkolonel Dritan Muka, në fjalën e tij vlerësoi punën e bërë nga kolegët e tij parardhës në këtë detyrë, për krijimin e emrit të mirë të këtij batalioni. Ai ndër të tjera theksoi: "Sfidat me të cilat ky batalion është përballur kanë qenë të panumërta dhe të gjitha këto sfida ky batalion i ka përballuar falë profesionalizmit dhe përkushtimit që kanë treguar drejtuesit dhe efektivet që kanë shërbyer dhe shërbejnë në këtë batalion."

Ceremoninë e përshëndeti dhe komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji.

"Jemi këtu për të shënuar përfundimin me sukses të shërbimit në këtë detyrë shumë të rëndësishme të nënkolonel Hoxhës, për t'i shprehur falenderimet dhe mirënjohjen tonë për punën e bërë, për rezultatet e arritura dhe kontributin e dhënë në krye të batalionit. Në përfundim të

## Nënkolonel Dritan Muka, komandant i Batalionit II të Këmbësorisë



fjalës time, dua t'i uroj nga zemra efektivit të këtij batalioni, punë të mbarë dhe suksese në detyrat tuaja përkatëse." – tha ai.

Pasi u lexua urdhëri i emërimit të komandantit të b2k, u zhvillua ceremonia e dorëzimit të flamurit luftarak.

## Në Norfolk, Virginia, Shtetet e Bashkuara

### Shqipëria është ndër themelueset e "Joint-Force Command"

**F**orcat e Armatosura shqiptare do të kontribuojnë me 2 oficerë në Komandën e Forcës së Bashkuar, që ka për qëllim mbrojtjen e linjave të komunikimit strategjik të Atlantikut të Veriut dhe parandalimin nga çdo sulm i mundshëm, "Shqipëria është krenare që është ndër shtetet themeluese të strukturës më të re të NATO-s, Joint-Force Command e vendosur në Norfolk, Virginia, Shtetet e Bashkuara.

në Norfolk të SH-BA-ve. Forcat e Armatosura shqiptare do të kontribuojnë me 2 oficerë në Komandën e Forcës së Bashkuar, që ka për qëllim mbrojtjen e linjave të komunikimit strategjik të Atlantikut të Veriut dhe parandalimin



nga çdo sulm i mundshëm, nëpërmjet angazhimit të Flotës së 2-të të Marinës amerikane", shkruan Ministri Xhaka ne facebook.

Roli i Shqipërisë në këtë komandë është domethënës duke kontribuar me dy oficerë në shtabin e kësaj komandë, krah për krah aleatëve tanë; SHBA, Gjermani, Turqi, Mbretërisë së Bashkuar, Itali, Kanada, Francë, Danimarkë, Greqi, Norvegji, Spanjë, Poloni, Islandë, Rumania dhe Bullgari.

# FA kontribut në Komandën e Bashkuar të NATO-s (JFCNF) Norfolk, Virginia

Në datën 2 tetor 2020, në Komandën Supreme të Aleancës, ACO SHAPE Mons, Belgjikë, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes së Krijimit të Komandës së re të NATO, Joint-Force Command Norfolk, ku morën pjesë komandanti Suprem i Aleancës në Europë (SACEUR), gjeneral Tod D. Wolters (US AIR-FORCE), shefi i Shtabit të ACO Admiral Joachim RÜHLE (DEU Army) dhe përfaqësuesit ushtarakë kombëtarë të shteteve pjesëmarrëse në këtë komandë, në SHAPE.

Për palën shqiptare në emër të Ministrisë së Mbrojtjes marrëveshja u nënshkrua nga përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar në SHAPE, ACO kolonel Petrit Çuni.

Në fjalën e rastit komandanti i JFCNF duke falënderuar SACEUR, gjeneral Tod D. Wolters dhe përfaqësuesit ushtarakë kombëtarë, theksoi: "Më shumë

“ Nënshkrimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi shënon suksesin e për-pjekjeve të mëdha të ndërmarrë nga NATO dhe vendet anëtare të saj për të riorganizuar Aleancën në mënyrë që të ruhet paqja dhe prosperiteti i vendeve dhe popujve.

se dy vjet më parë, në shkurt 2018, ministrat e Mbrojtjes së NATO të, në Këshillin e Atlantikut të Veriut, ranë dakord për përshtatjen e strukturës së komandës së NATO, duke përfshirë një strukturë të re, Nënkomanda Supreme e Aleancës në Europë, udhëhequr nga SACEUR, SHAPE, me fokus kryesor mbrojtjen e Atlantikut, si një strukturë e re ushtarakë e forcës së NATO. Më vonë, në qershor 2018, dakordësuan që

kjo komandë e re e Forcës së Përbashkët, të vendoset në Norfolk, Virginia me vend pritës SHBA.

Nën drejtimin e vendosur të Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara (USECOM), vendet pranuan të marrin pjesë në këtë seli të re dhe SHAPE mori si detyrë dhe në një kohë shumë të shkurtër u finalizua marrëveshja, teksti i Memorandumit të Mirëkuptimit, të cilin po e nënshkruajmë sot. Ky Memorandum Mirëkuptimi është







themeli i kësaj komande, lidhur me funksionimin, drejtimin, financimin, administrimin dhe mbështetjen e Forcës së Përbashkët, Komandës së Norfolkut. Ajo rregullon marrëdhënien dhe mirëkuptimin midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës si vend framework, SHAPE dhe vendeve kontribuese pjesëmarrës të kësaj komandë.

Bazur në Memorandumin e Mirëkuptimit, në korrik të vitit 2020, Këshilli Atlantikut të Veriut (NAC) vendosi të aktivizojë Komandën e Forcës së Bashkuar Norfolk si një strukturë ush-

tarake e NATO me statusin e Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar nën Protokollin e Parisit. Misioni Komandës së Norfolkut, tregon qartë angazhimin e Shteteve të Bashkuara dhe Aleatëve të tjerë të NATO për të mbrojtur Aleancën, nëpërmjet angazhimit të Flotës së 2-të të Marinës amerikane me qëllim mbrojtjen e linjave të komunikimit strategjik të Atlantikut të Veriut dhe parandaluar çdo agresion të mundshëm, duke kontribuar si forcë e reagimit të NATO. Për më tepër, krijimi i kësaj komande shkon në të njëjtën linjë me

përqasjen e re të Aleancës, për mbrotjen 360 gradë brenda kufijve të NATO dhe në përputhje me konceptin e ri të mbrojtjes për prandalimin dhe mbrojtjen euroatlantike (Deterrence and Defence Euro-Atlantic Area, DDA).

Roli i Shqipërisë në këtë komandë është domethënës duke kontribuar me dy oficerë në shtabin e kësaj komandë, krahas për krahas aleatëve tanë; SHBA, Gjermani, Turqi, Mbretërisë së Bashkuar, Itali, Kanada, Francë, Danimarkë, Greqi, Norvegji, Spanjë, Poloni, Islandë, Rumani dhe Bullgari.

Nënshkrimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi shënon suksesin e përpjekjeve të mëdha të ndërmarra nga NATO dhe vendet anëtare të saj për të riorganizuar Aleancën në mënyrë që të ruajmë paqen dhe prosperitetin e vendeve dhe popujve tanë."

Në përfundim duke vlerësuar rëndësinë që ka krijimi i kësaj komande, komandanti i JFCNF e mbylli fjalimin duke cituar fjalimin e ish-presidentit të SHBA Harry Truman, gjatë nënshkrimit të Traktatit të Uashingtonit, Traktati i Atlantikut të Veriut: "Për të krijuar një mburojë kundër agresionit dhe frikës nga agresioni, një mbrojtje, e cila do të na lejojë të vazhdojmë biznesin real të qeverisë dhe shoqërisë, biznesi i arritjes së plotë e një jetë më të lumtur për të gjithë qytetarët tanë".



# Në Poligonin Kombëtar të Bizës

## Përfundon stërvitja 72-orëshe e koduar “Stuhia 20-05”

*Rajoni i Bizës, me një arkiv të pasur historik për stërvitjet e FA, konsiderohet poligoni më i përshtatshëm për zhvillimin e stërvitjeve në kushte malore*

**K**ompania e Dytë dhe Kompania Mbështetëse e Batalionit II Këmbësorisë nga data 20 deri 22 tetor, zhvilloi stërvitjen 72-orëshe të koduar “Stuhia 20-05” në Poligonin Kombëtar të Bizës. Objektivat kryesor të kësaj stërvitje ishin perfeksionimi i veprimeve të kompanisë gjatë zhvillimit të dinamikës së luftimit, njohja dhe zbatimi i procedurave për drejtimin e trupave, aftësimin e komandantëve për përgatitjen e planeve dhe urdhrave, reagimin e trupës gjatë marrjes dhe shkëputjes të kontaktit me kundërshtarin gjatë lëvizjes, menaxhimi i stresit dhe ngarkesës fizike në kushte të vështira terreni dhe moti, rritja e aftësive operacionale të forcave pjesëmarrëse në stërvitje, etj.

Gjatë zhvillimit të stërvitjes në kushte marshimi, efektivat u përballën edhe me shumë situata të vështira, si lëvizjet në terrene malore. Rajoni i Bizës, me një arkiv të pasur historik për stërvitjet e FA, konsiderohet poligoni më i përshtatshëm për zhvillimin e stërvitjeve në kushte malore dhe një terren favorizues për të cilën efektivi e këtij nënreparti të batalionit, ashtu siç kanë treguar dhe më parë, shpalosi vlerat e tij në përmbushje të misionit të kësaj stërvitje 72 orësh, e cila për secilin oficer, nënoficer dhe



ushtarë profesionistë pjesëmarrës në stërvitje, nuk ishte e lehtë të përballlohet, kur mbi supet e tyre kishte dhe një ngarkesë fizike të pajimeve

dhe armatimit organik.

Stërvitje të kësaj natyre u aplikuan edhe me nënrepartet e tjera të këtij batalioni.



**N**ga data 12 deri më 23 tetor 2020, Kompania e Dytë operative e Policisë Ushtarake zhvilloi stërvitjen ushtarake “Limani 20” në Bazën Detare të Pashalimanit. Në këtë stërvitje tashmë të përvitshme merr pjesë edhe një grup-bordingu i Forcës Detare shqiptare. Trupat testuan dhe rritën aftësitë për reagimin në rastet kur sulmohet shoqërimi i një personi të rëndësishëm së veçantë, sulmi i pikave të kontrollit, lirimi i pengjeve në mjetet e transportit publik etj. Kjo stërvitje shërben për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve operative të efektivëve për operacionet që janë pjesë e përgjegjësisë së Policisë Ushtarake. Stërvitja “Limani 20” u mbyll me një skenar të improvizuar me detyrat që kryejnë kompanitë operative të Policisë Ushtarake. Në këtë stërvitje Policia Ushtarake angazhoi 35 trupa dhe 6 mjete tokësore, ndërkohë që në funksion të veprimeve të caktuara u përdorën edhe anijet e Forcës Detare.

# Zhvillohet stërvitja ushtarake “Limani 20”

Në këtë stërvitje Policia Ushtarake angazhoi 35 trupa dhe 6 mjete tokësore ndërkohë, që në funksion të veprimeve të caktuara u përdorën edhe anijet e Forcës Detare



**“U**shtarakët në lirim dhe në rezervë janë aset i vyer i Forcave të Armatosura. Falenderim e mirënjohje për të gjithë ushtarakët e ish-ushtarakët, që pavarësisht nëse janë ose jo pjesë aktive e FA janë angazhuar me përkushtim e profesionalizim në çdo sfidë të emergjencave civile”, tha ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhacka, në takim me Grupimin e Ushtarakëve në lirim dhe në rezervë. Ministrja Xhacka ka theksuar se, “kontributi i tyre është i mirëpritur në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e në çdo strukturë të FA, dhe do të vazhdojë të vlerësohet nga qeveria shqiptare për vetë disiplinën dhe përgjegjshmërinë që karakterizon secilin prej tyre”.

# Ushtarakët në lirim dhe në rezervë, një aset i vyer për FA





POLIGONI KOMBËTAR I BIZËS

# **BATALIONI “KOMANDO”**

## **Zhvillohet stërvitja “Albanët 20”**





**B**atalioni "Komando" sfidon motin dhe teston kapacitetet operative gjatë stërvitjes 72 orëshe "Albanët 20". Kjo stërvitje u zhvillua nga data 6 deri në 8 tetor, në poligonin kombëtar të Bizës dhe kishte për qëllim kompaktësimin e veprimeve kompani-batalion gjatë operacioneve që zhvillohen në kushte ekstreme moti dhe terreni. Testimi i gatishmërisë luftarake përfshiu: Procesi i Vendimarrjes Ushtarake (PVMU), dislokim në Zonën e Operacionit (ZO), testimi i komandim kontrollit,



Procesi i Drejtimit të Trupave (PDT), kryerja e marshimit natën, zbulimin, kalimi i vijës së frontit dhe goditje objekti. Të tilla stërvitje ndihmojnë dhe përgatisin trupën dhe liderët kryesor për përmbushjen e misionit të batalionit.

*Stërvitja u zhvillua nga data 6 deri në 8 tetor, në poligonin kombëtar të Bizës dhe kishte për qëllim kompaktësimin e veprimeve kompani-batalion gjatë operacioneve që zhvillohen në kushte ekstreme moti dhe terreni*





Kompania e I-rë dhe e II-të e aksioneve direkte

# **Batalioni i Forcave Speciale zhvilloi stërvitjen “Valbona-20”**

*Stërvitja kishte si synim standardizimin dhe  
përmirësimin e taktikave, teknikave dhe procedurave  
TTP për kryerjen e operacioneve speciale*

**N**ga data 13 deri 15 tetor 2020, kompania e I-rë dhe e II-të e aksioneve direkte të batalionit të Forcave Speciale, zhvilloi stërvitjen "Valbona-20" në rajonin e Valbonës, Tropojë. Në mbështetje të kësaj stërvitje mori pjesë një togë e batalionit Komando dhe një helikopter COUGAR i Forcës Ajrore. Kjo stërvitje kishte si qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë, standartizimin dhe përmirsimin e procedurave të planizimit sipas procesit të vendimarrjes ushtarake për Forcat Speciale, si dhe planizim dhe zgjidhje detyre konkrete në nivel Task-Grupi të Operacioneve Speciale SOTG. Për realizimin e kësaj stërvitje u angazhuan shtabet e dy kompanive në rolin e SOTG të cilët gjatë planizimit përdorën konceptin e vlersuesit të stërvitjes duke zbatuar listat e



kontrollit për çdo fazë. Kjo stërvitje kishte si synim standartizimin dhe përmirësimin e taktikave, teknikave dhe procedurave TTP për kryerjen e operacioneve speciale, (zbulim spe-

cial dhe goditje direkte).

Ajo filloi me marrjen e urdhërit nga komanda eprorë (SOCC) dhe u mbyll me një briefing para komandantit të operacionit. Trupat kaluan në zgjidhje detyre duke u infiltruar nga ajri në zonën e operacionit, grupet e zbulimit bënë konfirmimin e objektivave në terren, dërgimin e të dhënave të fundit të zbulimit mbi situatën e kundërshtarit dhe kaluan në mbështetje me zjarr të grupit të sulmit/depërtimit në objekt (Goditje Objekti). Pas përfundimit të sulmit grupi i zbulimit bëri vlerësimet e

dëmeve të shkatuara nga sulmi si dhe siguroi koridorin e largimit të grupit të sulmit gjatë tërheqjes. Toga komando në këtë stërvitje kishte për detyrë sigurimin e perimetrit të largët. Operacioni përfundoi me eksfiltrimin dhe rikthimin në vend-dislokimin e njësisë të manovrës. Pas përfundimit u zhvillua analiza pas veprimit APV ku vlersuesit, drejtuesit dhe pjesëmarrësit diskutuan mbi çfarë u bë mirë dhe çfarë nevojitet të përmirsohet sipas mësimave të nxjerra për tu integruar në programet e stërvitjes.



## Dita ndërkombëtare e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë

*13 Tetori është “Dita ndërkombëtare për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë”, një ditë së cilës i kushtohet tepër rëndësi, veçanërisht nga shtetet anëtare të OKB*

**A**gjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ka organizuar në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Kombëtar, prefekturat, bashkitë dhe Ministrinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë një aktivitet - si një ditë ndryshe me një vizion të qartë për të mirën publike - në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë”. Vetë drejtuesit i AKMC, Haki Çako, ka qenë i pranishëm në një nga takimet me nxënësit në kryeqytet ku u fol për fatkeqësitë natyrore që i kanosen vendit tonë. Çako theksoi se Shqipëria ka qenë së fundmi një rast unik në përballjen e fatkeqësive të ndryshme që e kanë goditur në të njëjtën kohë, siç ishin tërmetet e përsëritura, zjarret dhe Pandemia COVID-19.

13 Tetori është “Dita ndërkombëtare për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë”, një ditë së cilës i kushtohet tepër rëndësi, veçanërisht nga shtetet anëtare të OKB. Me këtë rast Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, Ministrinë e Arsimit, të Shëndetësisë dhe prefekturat, kanë bashkërenduar një aktivitet-zinxhir, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit të komunitetit në fushën e Mbrojtjes Civile. Këto aktivitete do të zhvillohen në shkolla të mesme dhe 9-vjeçare, si dhe sheshe të hapura në rrethet si Tiranë, Durrës, Dibër, Shkodër, Kukës, Lezhë, Elbasan, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë etj., për të



përcjellë tek brezat e rinj një kulturë ndërgjegjësuese ndaj zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë, me një theks të veçantë tek vullnetarizmi.

Aktivitetet gjatë ditës do të vijojnë me diskutime të hapura dhe shpërndarjen e broshurave informative pranë tendave në sheshe, në prani të përfaqësuesëve të arsimit, shëndetësisë, pushtetit vendor, AKMC-së etj., ku do jepet informacioni i nevojshëm për qytetarët.

Duhet theksuar që Shqipëria ka qenë së fundmi një rast unik në përballjen e fatkeqësive të ndryshme që e kanë goditur në të njëjtën kohë, si p.sh. tërmetet e përsëritura, zjarret dhe pandemia COVID-19. Qeveria shqiptare është angazhuar për ta përballuar me sa më shumë efikasitet këtë situatë, ku më poshtë vijojnë shembujt e disa zhvillimeve:

Miratimi i ligjit nr 45/19 për Mbrojtjen Civile dhe akteve të tjera nënligjore në funksion të këtij ligji. Investimi prej 1 milion euro për ngritjen e Qëndës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile

me të gjitha standartet. Investim prej 3 milion euro për ndërtimin e godinës sipas të gjitha standarteve europiane për AKMC-në. Investim prej 30 milion euro në ngritjen e të gjitha kapaciteteve të strukturave së mbrojtjes civile në rang kombëtar, me mjete, trajnime dhe pajisje profesionale. Projektme dhe investime të tjera në kuadër të parandalimit nga fatkeqësitë natyrore, me fokus të veçantë përmbytjet.

Në vëmendje të kësaj dite të veçantë ja vlen të përmendet vizioni i qartë që lidhet me politikën për ngritjen e Sistemit të Mbrojtjes Civile dhe Reduktimit të Riskut ndaj Fatkeqësive. Në vitin 1989, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së bëri thirrje për ta shënuar këtë ditë si një mënyrë për të promovuar një kulturë globale të ndërgjegjësimit ndaj rrezikut dhe reduktimit të katastrofave, kurse në vitin 2009, datën 13 Tetor, e vendosi si ‘Dita Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat.

# Memorandum bashkëpunimi me autoritetin e menaxhimit të TIA

Më datë 15 tetor 2020, në mjediset e Tirana International Airport (TIA) u organizua takimi për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit "Për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore", ndërmjet drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), z. Haki Çako dhe autoriteteve të menaxhimit të TIA, z. Constantin von Alvensleben, CEO dhe z. Volker Wendefeuer, COO.

Memorandumi synon krijimin e kuadrit bashkëpunues për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Aeroportin Kombëtar të Tiranës si dhe përcaktimi në mënyrë të qartë i të drejtave dhe detyrimeve konform Ligjit 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile" në RSH. Pas

Memorandumi u nënshkrua nga z. Haki Çako, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe autoriteteve të menaxhimit të TIA, z. Constantin von Alvensleben, CEO dhe z. Volker Wendefeuer, COO



nënshkrimit të këtij memorandumi u zhvillua një stërvitje simuluese në rast të një situatë ushtrimore emergjence në territorin e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", me

pjesëmarrjen e strukturave operacionale të Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, Mnzsh dhe strukturave të menaxhimit aeroportual.

## QENDRA E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE

**57** kursantë, ndër të cilët 2 prej tyre janë femra filluan në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve kursin e 67-të Fillestar të Nënoficerit.

Ky kurs, shënon hedhjen e hapave të parë drejt të bërit nënoficer në radhët e Forcave të Armatosura, si dhe konsiston në hedhjen e themeleve të një drejtuesi të ardhshëm në nivel grupi, që shkëputet nga përgjegjësia individuale. Kursantët e këtij kursi do të njihen me njohuritë bazë të punës së Nënoficerit me gradën Nëntetar.

Trajnimi i trupës së nënoficerave e ka filluesën e saj në vitin 1919 ku u hap për herë të parë shkolla dhe kurset e nënoficerave të cilët vijuan deri në vitin 1939. Në vitet 1950-1965 u hapën kurse të ndryshme të shërbimit për nënoficerë në komandatë përkatëse.

Më datë 05.11.1993, u hap Akademia e Nënoficerëve, me qendër fillimisht në vendin e quajtur 'Rrapi i

# 57 kursantë fillojnë kursin e 67-të fillestar të Nënoficerit

Kursantët e këtij kursi do të njihen me njohuritë bazë të punës së Nënoficerit me gradën Nëntetar



Treshit' në Tiranë. Më 08.04.1994 Akademia u vendos në garnizonin e Akademisë Ushtarake në Tiranë. Kjo shkollë e njëhsuar ka për mision përgatitjen e përqëndruar të nënoficerëve të karrierës duke rikthyer një traditë të përhershme dhe të konsoliduar. Objektivi i ANO-së ishte përgatitja dhe kualifikimi i

nënoficerëve aktivë e rezervistë për Forcat Tokësore, Detare dhe Ajrore. Pas vitit 2000 ndryshoi strategjia e arsimimit. Në bashkëpunim me vendet anëtare të NATO-s dhe me kompaninë SAIC filloi të realizohej përgatitja dhe trajnimi i nënoficerëve sipas niveleve të kurseve në ANO dhe Shkollën e Trupës.

## Kursi 45-të Bazë i Nënoficerit po ndiqet nga 60 kursantë

Kursantët e Kursit Bazë do të ndjekin programin mësimor për 8 javë me radhë

Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerëve (ANO), po zhvillonë me intensitet programin e saj mësimor, nën masa rigorozë sigurie dhe distancimi fizik, të imponuara prej pandemisë COVID-19. Trupa mësimore e QAPN-së (ANO-së) është e angazhuar maksimalisht në realizimin e kurseve të planëzuara vjetore. Me 10 shtator nisen mësimin kursantët e përzgjedhur për ndjekjen e Kursit 45-të Bazë të Nënoficerit në ANO. Ata po marrin njohuritë bazë të punës së nënoficerit me gradën Tëtar.

Kursantët e Kursit Bazë do të ndjekin programin mësimor për 8 javë me radhë. Gjatë këtij harku kohor programi mësimor i kursit do të ketë një ndërthurje të njohurive teorike dhe praktike, ku fokusi do të jetë marrja e njohurive bazë dhe të përgjithshme për përgatitjen e drejtuesve në rol të komandantit të



skuadrës në radhët e Forcave të Armatosura, njohuri të cilat kursantët i thellojnë më tutje pikërisht në

specialitetin përkatës. Të përzgjedhurit për të ndjekur këtë kurs janë 60 kursantë.

### NË KOMANDËN E FORCËS DETARE

## Kapiten i rangut III Emrush Bejdo, komandanti i ri i Shërbimit Hidrografik

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua më 19 tetor 2020, ceremonia e emërimit të komandantit të ri të Shërbimit Hidrografik, kapiten i rangut III Emrush Bejdo. Në ceremoni morën pjesë drejtues të Shtabit të Forcës Detare dhe personeli i Shërbimit Hidrografik.

Fillimisht komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhiu, vlerësoi karrierën dhe aftësitë profesionale të kapitenit të rangut III Bejdo dhe i uroi suksese në detyrën e re si drejtues i Shërbimit Hidrografik, një nga repartet me të rëndësishëm të Forcës Detare.

Në fund të ceremonisë kapiteni i rangut III Bejdo tha: "Emërimin në këtë detyrë e quaj nder dhe përgjegjësi, ndaj së bashku me



efektivin e Shërbimit Hidrografik do punojmë për të mbajtur në gatishmëri optimale këtë sistem të

rëndësishëm jo vetëm për Forcën Detare, por për gjithë përdoruesit e detit."



**M**ë datë 9 tetor në ambientet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak Shqiptar u zhvillua një vizitë njohëse me deputetët e Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare. Deputetët e Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare u pritën nga shefi i Shtabit të Forcës Ajrore kolonel Genci Petanaj, zëvendës drejtori i SHMU major Rudina Zaçe. Duke ju uruar mirëseardhjen në këtë takim major Zaçe me anë të një brifingu i njohu deputetët pjesëmarrës me misionin, strukturën, historikun, detyrat, me bashkëpunimet dhe planet që ky shërbim ka për të ardhmen.

Deputetët e Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, përmes pyetjeve kërkuar të njihen e të informohen mbi operacionalitetin e aparaturave që ka në përdorim SHMU-ja, si dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera shtetërore e private mbi shërbimin meteorologjik në ndihmë të Emergjencave Civile. Ky takim u mbyll me vizitën e pjesëmarrësve në ambientet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak.

Meteorologjia është shkencë që nëpërmjet studimit të faktorëve që rregullojnë dinamikën e atmosferës dhe të hidrosferës, kërkon të parashikojë evoluimin e motit e të klimës mbi një shkallë rajonale e globale. Zhvillimi i ekonomisë, i jetës, dhe i njohurive të shoqërisë në tërësi ka influencuar gjithmonë në përparimin e shkencës së parashikimit të motit, sepse, siç dihet, janë të pakta ato veprimtari të njeriut që nuk lidhen me reshjet, temperaturat, erërat etj. Por, një zhvillim të madh shkencë e meteorologjisë e pati me fillimin e fluturimeve ajrore. Ekziston një lidhje tepër e ngushtë ndërmjet fluturimeve ajrore dhe shkencës së meteorologjisë, pasi kjo e fundit garanton kondita normale të fluturimeve kombëtare e ndërkombëtare.

Edhe në vendin tonë zhvillimi

## Informim për Shërbimin Meteorologjik Ushtarak Shqiptar



i shkencës së meteorologjisë ka historikun e saj. Vlerat e para të elementeve meteorologjike janë matur, në vitin 1887, në qytetin e Shkodrës. Më pas kanë filluar të maten dhe në qytetet Durrës, Tiranë, Korçë e Vlorë. Por, këto vendmatje në të cilat punonin persona të huaj, priftërinj jezuit, nuk ishin dot në gjendje të formonin rrjetin e Shërbimit Meteorologjik. Deri para çlirimit të vendit kishte vetëm një zyrë hidrografie pranë Ministrisë së Punëve Botore dhe një zyrë meteorologjike pranë Ministrisë së Bujqësisë. Një rrjet meteorologjik kombëtar, që do të përfshinte tërësinë e shërbimeve meteorologjike në të gjithë vendin, u arrit të krijohet në vitin 1949 nga Instituti i Shkencës. Për këtë qëllim, ishin montuar me kohë nëntë vendmatje të pajisura me aparatura normale të kohës dhe që ndodheshin në qytetet Shkodër, Kukës, Peshkopi, Durrës, Tiranë, Kuçovë, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Siç shihet vendmatjet ishin të shpërndara në të gjithë vendin, në vise e largësi të ndryshme, në kushte të ndryshme klimatike dhe në to punohej 24 orë në ditë. Elementet meteorologjike të

vrojtura në çdo stacion gjatë ditës ishin: diellëzimi, shikimi horizontal, vranësitat, drejtimi dhe shpejtësia e erës, presioni atmosferik, temperatura e ajrit dhe e tokës, lagështira, avullimi si dhe reshjet. Vrojtimi i vlerave të tyre bëhej i pjesshëm në çdo orë dhe i plotë në çdo tre orë. Gjithashtu, çdo ditë vetëm në Stacionin Qendror Tiranë punoheshin me dorë dhe analizoheshin katër harta sinoptike tokësore të cilat shërbenin për të mbuluar me parashikim moti të gjithë territorin e vendit. Transmetimi dhe marrja e të dhënave meteorologjike si brenda ashtu edhe jashtë vendit bëhej çdo tre orë në Stacionin Qendror me sistemin mors nëpërmjet valëve radio. Në kuadrin e modernizimit të rrjetit të Shërbimit Meteorologjik, në shtator 2004 në Stacionin Qendror Tiranë është instaluar programi "Nubis". Nëpërmjet këtij programi u realizua marrja e informacionit meteorologjik në mënyrë satelitore dhe po me anë të këtij programi më 23 shtator 2004 filloi dhënia e informacionit të motit në televizionin publik shqiptar nga ana e Shërbimit Meteorologjik të Forcave Ajrore.

**M**inistrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka tha se në 3 vjet reformë, Emergjencat Civile janë modernizuar dhe profilizuar për përballimin e rreziqeve natyrore. “Mbi 2 mijë efektivë janë trajnuar për të reaguar në tërmete, përmytje apo edhe pandemi si kjo e Covid-19”, tha ajo.

Xhaçka shprehet se ka nisur një proces ambicioz për modernizimin dhe transformimin e Emergjencave Civile. “Kemi nisur një proces ambicioz modernizimi e transformimi të emergjencave civile, duke kaluar një ligj të hartuar me mbështetjen e partnerëve, duke ngritur Agjencinë e Mbrojtjes Civile dhe duke mirëpajisur e trajnuar efektivët e FA të profilizuar për emergjencat. Mbi të gjitha kemi bërë progres në transformimin e qasjes ndaj rreziqeve natyrore, duke e kaluar fokusin, nga reagimi tek parandalimi”, u shpreh ministrja.

Tashtë ambicja e emergjencave është, sipas ministres Xhaçka, anëtarësimi në Mekanizmin e BE-së për Mbrojtjen Civile. “Ia kemi dalë që në vetëm një vit, të arrijmë një nivel gatishmërie e operativiteti që në planet fillestare do të kishte kërkuar së paku 4 apo 5 vjet. Por sigurisht



## EMERGJENCA CIVILE

# Modernizim dhe profilizim për përballimin e rreziqeve natyrore

Mbi 2 mijë efektivë të trajnuar për tërmete, përmytje apo edhe pandemi

kemi shumë rrugë për të bërë akoma, derisa struktura për të cilën po punojmë të jetë e standardeve

që kërkohen për t'u anëtarësuar në Mekanizmin e BE për Mbrojtjen Civile”, theksoi ajo.

## Batalioni i Forcave Speciale feston 22 vjetorin e Krijimit

**N**ë ambientet e Repartit 1050 u zhvillua me 17 tetor 2020, Ceremonia e 22 - vjetorit të Krijimit të Batalionit të Forcave Speciale. Në këtë aktivitet, mori pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, përfaqësues nga shtabi i Forcës Tokësore, ish - komandantë të bFS, komandantë repartesh të FT, si dhe ish - pjesëtarë të bFS.

Fjalën e hapjes në këtë ceremoni e mbajti komandanti i bFS, nënkolonel Ajet Jata, i cili pasi bëri një përmbledhje të rrugëtimit të bFS që prej themelimit të tij e deri në ditët tona, adresoi një falënderim të veçantë dhe mirënjohje për të gjithë efektivat e bFS dhe veçanërisht për drejtuesit e bFS, që kanë kontribuar ndër vite në këtë repart. Më tej nënkolonel Jata shprehu falënderime dhe mirënjohje të veçantë për aleatët tanë të NATO-s, për kontributin e tyre të çmuar për rritjen profesionale të efektivëve të Forcave Speciale.

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben



Kingji, në fjalën e tij përshëndetëse përgëzoi përkushtimin, profesionalizmin, ndjenjën e lartë të përgjegjësisë që kjo njësi ka treguar ndër vite duke përfaqësuar vlerat më të mira të FA, kauzës për të cilën ka shërbyer ndaj vendit, aleatëve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë. Gjeneral brigade Kingji ndër të tjera theksoi: “Kjo njësi nuk do të ishte këtu sot, pa ndihmën e partnerëve tanë strategjikë dhe në mënyrë të veçantë SHBA, të cilët kanë rritur dhe përmirësuar kapacitetet operacionale luftarake, falë mbështetjes me instruktorë të FS në fushën e trajnimit të shtabit dhe trupave para dislokimit në zonat e rrezikut, si dhe në operacionet direkte luftarake në Afganistan. Kanë kaluar 22 vite, por kemi

dhe shumë rrugë për të bërë, për t'u rritur dhe zhvilluar, ndaj kam detyrimin t'ju flas si Komandant i FT, por edhe si ish - pjesëtar i kësaj njësie se ky batalion do të ketë mbështetjen time të pakursyer gjithashtu të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes.”

# Shpëtim Shahini, nderohet me “Certifikatën e Mirënjohjes”

Më datën 12 tetor 2020, me rastin e daljes në rezervë, nënoficer Shpëtim Shahini, u vlerësua me “Certifikatën e Mirënjohjes”, për kontributin e tij mbi 30 vjetar në Focat tona të Armatosura, kryesisht në Forcën Detare, Në emër të Komandantit të Forcës Detare, “Certifikatën e mirënjohjes”, ja dorëzoi Shefi i Shtabit i Forcës Detare, Kapiteni Rangut të II-të Sabri Gjinollari dhe Shefi i personelit, Kapiteni Rangut të II-të, Diodor Muja.

Zoti Gjinollari vlerësoi përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar nga nënoficer Shahini në kryerjen e detyrave të ngarkuara, që nga ajo e radiotelegrafistit, ku ai ishte nga nënoficerët e pare që bashkëpunoi me homologët e NATO-s, gjatë embargos ndaj ish Jugosllavisë. Më pas nënoficer Shpëtimi, kreu detyra të rëndësishme në postet luftarake për ndjekjen e situatës detare. Në të gjitha detyrat që kreu Kapter Shpëtim Shahini, u dallua për korrektësi në zbatimin e detyrave, disiplinë, etikë e nivel si ushtarak, shembull për brezat e nënoficerëve të ardhshëm në Forcën Detare. Dashurinë dhe respektin që ka për Forcën Detare, Shpëtimi e tregoi dhe me një veprim konkret, pasi djali i tij Mariusi, ka dy vjet që është pjesë e Forcës Detare, si Detar IV-të. Në fund, Shefi i Shtabit i FD, i uroi Kapter Shpëtim Shahinit, shëndet e pension të qetë, bashkë me familjen. Nënoficer Shahini do jetë i mirëpritur kurdoherë në Komandën e FD.



## Specialistët EOD shëmbin pallatin 12-katësh

Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios në Komandën Mbështetëse në bashkëpunim me Inspektoriatin Kombëtar të Mjedisit dhe Territorit (IKMT) bënë të mundur shkatërrimin e pallatit 12-katësh në Lagjen nr. 17 të Bashkisë Durrës, të dëmtuar në nëntorin e vitit të kaluar. Ky është konsideruar një nga operacionet më të vështira deri më tani, pasi u desh një punë voluminoze për hapjen e mbi 3000 furnelave nga ekspertët e Batalionit të Xhenios.

Kjo punë ka filluar që në muajin korrik 2020 dhe u finalizua mbasditen e të shtunës që kaloi. Për realizimin e këtij operacioni u përdor një sasi e konsiderueshme lënde plasëse, tre mjete transporti, një agregat dhe 39 specialistë të Batalionit të Xhenios. Gjatë operacionit nuk pati problem.





# Femrat ushtarake përbëjnë rreth 14 % të personelit ushtarak të FA

**N**ë kuadrin e 50 vjetorit të Kursit të Parë të Oficereve shqiptare, Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë në Bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës në datën 4 tetor 2020, organizoi një aktivitet pranë Muzeut Historik Kombëtar për promovimin e librit “Gratë oficere në rrjedhën e historisë” dhe filmit dokumentar “Ato janë të parat”. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe zv/shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralbrigade Manushaqe Shehu e cila mbajti fjalën: “Mbi vlerat e librit në dokumentimin e gruas shqiptare në historinë e Forcave të Armatosura”.

Gjeneralebrigade Manushaqe Shehu, në këtë promovim, tha se: “Sot femrën ushtarake, ashtu si edhe dje e gjen kudo, në stërvitje në trajnim në auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe të Akademive Ushtarake jashtë vendit. Atë e gjen ushtarë profesioniste në fushat dhe poligonet e stërvitjes, nënofficere dhe oficere gati në gjithë Shqipërinë, kudo ku ka reparte ushtarake. Atë e gjen në misionet paqeruajtëse në Afganistan, në Letoni, në Sudanin e Jugut, në Përfaqësitë Ushtarake në Bruksel, në shtabet e NATO-s, por e gjen edhe si politikane në parlamentin shqiptar. Atë e gjen prefekte, atashe ushtarake, komandante të strukturave të ndryshme, atë e gjen në të gjitha gradat, përfshi edhe ato të larta e madhore, kolonele e gjenerale.

E ku nuk e gjen sot femrën ushtarake shqiptare, si ato që vijojnë karrierën ushtarake ashtu edhe ato që kanë dalë në rezervë dhe janë aktive në jetën shoqërore të vendit. Kudo është dora, mendja dhe fuqia e saj mendore e fizike.

Miratimi dhe zbatimi i “Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore”, në mbështetje të rezolutës 1325 “Gruaja, Paqja dhe Siguria”, miratu-

“Promovohet libri “Gratë oficere në rrjedhën e historisë” dhe dokumentari “Ato janë të parat”.



ar nga Ministri i Mbrojtjes, ka bërë që femra ushtarake aktive sot të përbëjnë rreth 14 % të personelit ushtarak të FA, me synimin për të arritur shifrën prej 15 %. Po ashtu miratimi i para disa muajve të dokumentit “Politikat dhe procedurat e mbrojtjes kundër ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale në punë”, tregon kujdesin e vazhdueshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, znj. Olta Xhacker, ndaj femrave dhe në veçanti ndaj femrës ushtarake.

Unë jam një kolegja juaj e brezit të viteve 1984-1988. Secila nga ju ka se çfarë të kujtojë nga jeta ushtarake. Secila nga ju ka patur një idhull në jetë. E kush nga ne nuk dëshironte t'i ngjante komandantes Sheqere Mema, një oficere e spikatur e Forcave të Armatosura. E kush prej nesh nuk dëshironte të ishte si oficere Lirjana Sulkuqi,

një drejtuese e aftë, një motër dhe nënë për ne në atë kohë, por mbi të gjitha edhe një krijuese me talent të rrallë. Apo Lida Grazhdanit, e cila aq bukur e ka përshkruar jetën e femrës shqiptare në librin “Pesha dhe bukuria e uniformës”, Liljana Meros e kudo gjendur dhe sot aktiviste e shquar e Shoqatës së Ushtarakëve në Rezervë.

Por sot me siguri femrat ushtarake aktive kërkojnë të jenë si: kolonele Vehbie Kuti, aktualisht në shtabin e KFOR-it në Kosovë, nënkolonele Elsa Prasta në Përfaqësinë Ushtarake në Bruksel, nënkolonele Arta Driza, kampione dhe gjyqtare ndërkombëtare e sportit të shahut, kapiten Viola Hoxha dhe majore Valentina Korbi që sapo përfunduan misionin paqeruajtës prej një viti në Sudanin e Jugut, kapiteneve Elinora Metolli dhe Rudina Pina, që sapo kanë shkuar



në mision, e plotë të tjera femra, të cilat kanë sakrifikuar çdo gjë për Forcat e Armatosura.

Sakrificat e femrës ushtarake shkojnë edhe me dhënien e jetës, siç ishte rasti i aktit sublim të "Dëshmoret të Atdheut", nëntetares Zarife Hasanaj. E shembuj të tillë patjetër që ka secila nga ju. Por le t'i kthehemi qëllimit për të cilën dy autorët Kujtimi e Zana na kanë mbledhur. Libri "Gratë oficere në rrjedhën e historisë", Volumi i dytë, është një përpjekje e lavdërueshme dhe një kontribut i veçantë i dy autorëve për të përmbledhur në një botim enciklopedik me vlera për gratë luftëtare dhe komandante në histori, e që shumë prej tyre dhanë jetën në periudha të ndryshme të historisë tonë kombëtare për lirinë, pavarësinë, ndërtimin, zhvillimin e ruajtjen e shtetit të pavarur e modern shqiptar. Ka kaluar mbi gjysmë shekulli në Forcat e Armatosura që vajzat dhe gratë shqiptare kanë nisur studimet në Shkollën e Bashkuar dhe të përpjekjeve shumë vjeçare në ushtri. Këto ishin përfaqësuese të një brezi që ecën në gjurmët e vajzave e grave trimëresha partizane, por edhe më parë që kishin rrëmbyer armët për mbrojtjen e vendit dhe çlirimin e tij. Libri reflekton të gjitha gratë ushtarake që figurojnë si të tilla në të gjithë dokumentacionin e shtetit shqiptar. Ky volum i dytë i librit, është një botim i cili jep një ndihmesë dhe kontribut të madh në njohjen me jetën dhe veprimtarinë e gruas ushtarake në histori. Shpresoj se ky libër do të jetë një ndihmë për të gjitha institucionet shtetërore, për Ministrinë e Mbrojtjes, për kërkuesit e historianët, si dhe të gjithë familjarëve që kanë emrin e grave ushtarake që kanë bërë emër

të mirë në histori dhe pasardhësit e tyre do të krenohen për veprën dhe luftën titanike të bëra nga gjyshet e nënat e tyre.

Praktika e ndjekur për hartimin e këtij libri, puna me materiale dokumentare, arkiva, puna kërkimore, pyetësorët, shtypi ushtarak, si dhe libra me temë nga Forcat e Armatosura, na sjellin një bibliografi të një jetë të gjatë të pionierëve të para ushtarake që me guxim hapën rrugë dhe shtigje të reja për gruan shqiptare. Kjo përvojë ishte një dëshmi e emancipimit të saj, e cila me guxim dhe kurajo, me durim dhe këmbëngulje, me vullnet dhe pasion, bëri që ushtria të mësonte prej tyre. Nëpërmjet faqeve të librit dalin personazhe të grave me uniformë në vite që me punën e tyre dinjitoze e integruan atë në ushtrinë shqiptare duke bërë të përbashkët pjesëmarrjen e tyre në pozicion të barabartë me burrat. Vajzat dhe gratë shqiptare u arsimuan dhe shërbyen në radhët e Forcave të Armatosura me dinjitet. Libri është reflektim i një pune të gjatë e voluminoze të gruas ushtarake gati më shumë se gjysmë shekullor e cila ka qenë bashkudhëtare në historinë e Forcave të Armatosura duke lënë gjurmë të arta në të gjithë treguesit e gatishmërisë luftarake. Libri na jep të dhëna të reja ku bëhet evidentimi dhe njohja e vlerave të ushtarakes shqiptare, për të cilët deri më sot nuk kemi pasur të dhëna të plota.

Pavarësisht se libri është një renditje dhe klasifikim i emrave të grave ushtarake, por pas secilit emër qëndron një histori e madhe, një jetë aktive në shërbim të atdheut. Janë pikërisht këto vlera të mëdha njerëzore, ato që i japin kuptim historisë, ato që përbëjnë ng-

jarje të mëdha në jetën e një kombi e shteti, ato që evidentojnë rolin e gruas ushtarake në përcaktimin e zhvillimeve të rëndësishme historike të Forcave të Armatosura. Historia e Shqipërisë, është histori lufte për mbijetesë, e përpjekjeve për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin kombëtar, e sakrificave të mëdha për liri e mëvetësi, ku gruaja shqiptare dhe ajo luftëtare dhe ushtarake ka luajtur një rol parësor. Libri është historia e gruas ushtarake e këtij kombi. Pas Luftës së Dytë Botërore gratë ishin pjesë e Forcave të Armatosura në shumë vende, ku u bënë dhe prioritete të politikave dhe strategjive shtetërore për barazi gjinore. Shqipëria si vend anëtarë i Aleancës ka një përqindje të ndjeshme të grave me uniformë. Shqipëria dhe Forcat e Armatosura krenohen me përparimet që ka bërë gruaja ushtarake, ajo sot është më e sigurt, më e përparuar, më pranë familjes së madhe evropiane, e barabartë me gruan ushtarake të aleancës në NATO. Kjo është pjesë e meritës së tyre. Kjo na detyron që të jemi mirënjohës duke i vlerësuar për punën e tyre, duke ndjerë krenari për sakrificat e bëra në rrugëtimin e tyre nën uniformën ushtarake.

Në vijim të programit sot do të kemi rastin të ndjekim edhe filmin dokumentar "Ato janë të parat", kushtuar 50 vjetorit të Kursit të Parë të Oficereve shqiptare. Me këtë rast dua të falënderoj iniciuesit e këtij filmi, Shoqatën Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë, në mënyrë të veçantë regjisorin e talentuar me shumë eksperiencë e të palodhur, ish ushtarakun Verdi Taken, i cili edhe pse këtë moshë të thyer po na sfidon me memorien dhe freskinë e mendimeve të tij artistike".

## Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, organizimi dhe detyrat funksionale

**D**etyra kryesore funksionale e Sherbimit Meteorologjik Ushtarak janë: asistencë mbi gjendjen reale të motit dhe tendencën e saj për një periudhë disa ditore në mbështetje të plotësisht të detyrave për mbrojtjen e sigurimin kombëtar. Për të realizuar këtë detyrë duhet të: kryejë monitorimin e panderprere 24 ore, të proceseve e dukurive atmosferike, sipas udhëzuesve të vërtetimit meteorologjik, në vendmatjet meteorologjike në varësi të këtij shërbimi, regjistrimin e të dhënave të vërtetimit dhe përpunimin e tyre në tabelat perkatese, grumbullimin dhe arkivimin e informacionit operativ nga vendmatjet meteorologjike në varësi të këtij shërbimi në qendër (Tiranë), dërgimin e informacionit meteorologjik në arkivën kombëtare meteorologjike pranë Institutit Hidrometeorologjik të Akademisë së Shkencave, kundrejt mareveshjes për përcaktimin e detyrimeve të ndërsjella, sigurimin e informacionit meteorologjik në shtresat e sipërme të atmosferës, përpilimin e diagramave termodinamike, përpilimin e buletinit meteorologjik për gjendjen reale të motit dhe parashikimin e tij.

Shefi i Sherbimit Meteorologjik Shefi i Sherbimit Meteorologjik Ushtarak është oficer aktiv dhe varet direkt nga Komandanti i Forcave Ajrore dhe ka për detyrë: të drejtojë dhe kordinojë punën në shërbimin meteorologjik ushtarak. Në bashkëpunim me Institutin Hidrometeorologjik të hartojë programet e kualifikimit të vazhdueshëm të personelit, të kontrollojë zbatimin e programit të kualifikimit të personelit (që nga vërtetues deri në

“ Vërtetimet meteorologjike në vendmatjet e rrjetit të Sherbimit Meteorologjik Ushtarak, kryhen në përputhje me udhëzuesit teknikë të Organizatës Botërore të Meteorologjisë.



sinoptikan). Ai dhe i ngarkuari i tij brenda juridiksionit, është përfaqësuesi i Sherbimit Meteorologjik Ushtarak në të gjitha nivelet dhe nevojat e përfaqësimit. Vetëm ai dhe personat e autorizuar prej tij, kanë të drejtë të marrin informacion meteorologjik në rrjetin e shërbimit meteorologjik ushtarak.

Shefi i zyrës qendrore varet nga Shefi i Sherbimit Meteorologjik Ushtarak, zëvendëson atë dhe ka për detyrë: të organizojë dhe garantojë mbarevajtjen e punës në zyrën qendrore, të marrë pjesë çdo ditë në konsultën e mëngjesit dhe në të gjitha konsultat e tjera të thirrura në varesi të situatës meteorologjike

te ndjekur nga sinoptikanti i shërbimit, të drejtojë analizën mujore të punës me personelin e zyrës qendrore, të kordinojë punën për plotësimin e nevojave për informacion të artillerisë kundërajrore dhe zyres së parashikimit, të kordinojë marrëdhëniet ndërmjet shefave të seksioneve për shkëmbimin e informacionit meteorologjik të mbledhur nga vërtetimet në të gjithë rrjetin.

Shefi i degës pranë aeroportit varet nga shefi i Zyres Qendrore. Ai ka për detyrë: të organizojë dhe drejtojë punën në degën e tij, të bashkëpunojë me komandën e reparitit për planizimin e fluturimeve, të bëjë asistencën meteorologjike gjatë



fluturimeve ajrore, në bashkëpunim me IHM te kontrolloje gjendjen dhe funksionimin normal te aparaturave meteorologjike, te pergatise buletin meteorologjik ne ditet e pergatitjes per fluturim dhe te raportoje para efektivit pilot mbi kushtet e motit per ditën e fluturimit, te pergatise buletin meteorologjik ne ditën e fluturimit, te raportoje per kushtet aktuale te motit dhe ecurine e tyre gjate periudhes se fluturimit.

Ne rastet kur ka fenomene atmosferike te rrezikshme per fluturimin vë ne dijeni menjehere udheheqesin e fluturimit. Per cdo problem qe lidhet me mbarevajtjen e punes, vë ne dijeni shefin e Zyres Qendrore dhe shefin e Sherbimit Meteorologjik Ushtarak. i. Organizon punen per dhenien e informacionit meteorologjik ne zyrën qendrore. j. Ndjek dhe ploteson dokumentacionin e nevojshem per realizimin e detyrave.

Shefi i deges eshte sinoptikan dhe varet nga shefi i Zyres Qendrore. Ai ka per detyre: te organizoje dhe kontrolloje punen ne dege, te informoje shefin e Zyres Qendrore dhe shefin e Sherbimit Meteorologjik Ushtarak per cdo problem qe ka lidhje me mbarevajtjen e punes, te organizoje punen per dhenien e informacionit meteorologjik ne Zyrën Qendrore. Në bashkëpunim me IHM te kontrolloje gjendjen dhe funksionimin normal te aparaturave meteorologjike, te ndjeke dhe plotesoje dokumentacionin e nevojshem per realizimin e detyrave, mban pergjegjesi per futjen e personave te pautorizuar ne stacion.

Shefi i seksionit te parashikimit te motit eshte ushtarak aktiv ose civil, i cili varet nga Shefi i Zyrës Qendrore dhe ka per detyre: te organizoje, drejtoje dhe pergjigjet per mbarevajtjen e punes ne seksionin e parashikimit, te kontrollojë zbatimin e programit të aftesimit profesional te personelit te seksionit qe drejton, te vere ne dijeni shefin e Zyres Qendrore per cdo problem apo nevojë qe lind gjate punes dhe per mbarevajtjen e saj.

Parashikimi i motit, nga 24 orë deri ne 5 ditë, kryhet nga Zyra Qendrore në Tiranë. Në degët e tij do të kryhet parashikimi me afat deri në 6 orë (nowcasting). Parashikimi i motit kryhet mbi bazën e analizës dhe interpretimit të informacionit mbi proceset atmosferike në siperfaqen e tokës dhe shtresat e sipërme të atmosferës.

Sinoptikani varet nga shefi i Seksionit te parashikimit te motit. Ai ka per detyre: te ndjeke ne vazhdimesi

evolucionin e proceseve atmosferike. Analizon hartat sinoptike tokesore. Analizon hartat aerologjike 850mb, 700mb, 500mb, 300mb, 100mb. Merr nga seksioni i informacionit te dhenat e rrjetit te sherbimit meteorologjik ushtarak. Ben parashikimin e motit dhe pergatit buletin meteorologjik. Jep informacion meteorologjik per te gjitha entet e percaktuara ne Ligjin e Sherbimit Meteorologjik Ushtarak dhe aktet nenligjore ne fuqi. Ne cdo rast kur konstaton mundësinë e shfaqjes së ndonje dukurie të jashtëzakonëshme atmosferike, vë ne dijeni Shefin e Zyres.

Shefi i vendmatjes meteorologjike ne Tirane varet nga shefi i Zyres Qendrore. Shefi i vendmatjes meteorologjike ne dege varet nga shefi deges. Ai ka per detyre: e organizoje dhe kontrolloje vrojtimit në përputhje me udhëzuesin e vrojttimeve meteorologjike, te kontrolloje gjendjen dhe funksionimin normal te aparaturave meteorologjike, te ndjeke ecurine e dokumentacionit deri ne arshivimin e tyre, mban pergjegjesi per ecurine e puneve te



vendmatjes dhe per cdo problem vë ne dijeni shefin e deges, te organizoje dhe drejtoje aftesimin profesional te personelit te vendmatjes.

Vrojtimit meteorologjike ne vendmatjet e rrjetit të Sherbimit Meteorologjik Ushtarak, kryhen në përputhje me udhëzuesit teknikë të Organizates Boterore te Meteorologjise. Vrojtuesi Vrojtuesi varet nga shefi i vendmatjes meteorologjike dhe ka per detyre: te beje vrojtimit dhe regjistrimin e elementeve meteorologjike sipas udhëzuesit te vrojttimeve meteorologjike. Per cdo problem qe ka te beje me mbarevajtjen e punes te vere ne dijeni shefin e seksionit te vrojtimit. Të mos lejojë asnje person te pautorizuar te hyje ne zyren e punes. Pergjigjet per bazen materiale dhe instrumentat meteorologjike ne perdorim dhe i

dorezon me pergjegjesi ato.

Ne fillim te sherbimit vrojtuesi kontrollon dhe shenon ne librin e marrjes dhe dorezimit te sherbimit gjendjen e kontrolluar te stacionit. Ne perfundim te sherbimit vrojtuesi dorezon ne gjendje te rregullt vendmatjen meteorologjike dhe zyren e punes. Ruajtja e te dhenave te vrojtuar Formulet e ndryshem dhe ditaret per regjistrimin e vrojttimeve sistemohen mire dhe ruhen me kujdes ne dollap te mbyllur. Pas mbylljes se muajit ditaret sistemohen ne arkive. Informacioni i grumbulluar nga vendmatjet e rrjetit kombëtar meteorologjik dërgohet në Arkivën Kombëtare Meteorologjike pranë Institutit Hidrometeorologjik, ne baze te mareveshjes se nenshkruar midis dy paleve. Specialisti i aerologjise siguron informacion mbi shtresat e sipërme te atmosferes per nevojat te ndryshme te sherbimit meteorologjik. Asiston dhe jep informacionin e nevojshem per zhvillimin e qitjeve kunderajrore. Shefi i seksionit te informacionit varet nga shefi i Zyrës Qendrore. Ai ka per detyre: te organizoje dhe kontrolloje

punen ne seksionin e informacionit, te kontrolloje gjendjen dhe funksionimin normal te aparaturave qe ka ne perdorim, te ndjeke ecurine e punes per koordinimin e shkembimit e te dhenave me te gjitha degët dhe seksionet, te mbledhe te dhenat meteorologjike nga rrjeti i sherbimit meteorologjik ushtarak, t'i perpuñoje dhe transmetoje ato ne rrjetin nderkombetar. Operatori Operatori varet nga shefi i seksionit te informacionit dhe ka per detyre, te mbledhe te dhenat ne oret e caktuara dhe jashte ketyre oreve ne raste emergjencash, te perpuñoje informacionin meteorologjik dhe te plotesoje dokumentacionin perkates duke e pergatitur ate per arkivim, ti jape zyres se parashikimit te motit informacionin e marre nga rrjeti i sherbimit meteorologjik ushtarak.



**D**uke bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe nenin 11, paragrafi 4 i Rregullores Nr.03/2020 për Rekrutim në FSK, si dhe duke pasur për bazë ofertës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ministria e Mbrojtjes shpall konkursin për rekrutimin e 12 kandidatëve të rinj për shkollim në Akademitë Ushtarake West Point dhe Forcave Ajrore në SHBA.

Ministria e Mbrojtjes bën pranimin e kandidatëve të cilët do të studiojnë në shkollime jashtë vendi si vijon: Shkollimi në Akademinë Ushtarake West Point 6 kandidatë, Shkollimi në Akademinë e Forcave Ajrore 6 kandidatë.

Kandidati/tja që aplikon për pranim në Akademitë në SHBA duhet të: Jetë shtetas i Republikës së Kosovës; ketë zotësi të plotë për të vepruar; ketë kryer shkollën e mesme, përfshirë dhe testin kombëtar të maturës; mos jetë i/e dënuar apo i/e ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë; jetë i moshës 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik (1 korrik 2021); ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen; mos ketë tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrah nga pjesa e bicepsit e deri te gishtat e dorës duke përfshirë edhe pirsing; ketë notën mesatare gjatë shkollimit të mesëm të lartë "shumë mirë e lartë"; ketë njohuri të mira me



Akademia Ushtarake West Point dhe Akademia e Forcave Ajrore në SHBA

## Shkollat ushtarake amerikane ofrojnë 12 bursa studimi

Konkursi është i hapur nga data 7 tetor deri në 20 tetor 2020



rrijshëm të mjaftueshme të gjuhës angleze në të folur, shkruar dhe në të kuptuar; plotësoj standardet për lider/e, akademike, fizike dhe mjekësore; mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike; të ketë shikim të mirë dhe pa ndonjë problem dental të theksuar; arrijë në testin Scholastic Aptitude Test (SAT), pjesën e matematikës jo më pak se 580

pikë dhe pjesën me shkrim dhe lexim i bazuar në evidencë (EBRW) jo më pak se 480 pikë; kaloj me sukses testin fizik, Candidate Fitness Assessment (CFA), i cili përbëhet nga hedhja e topit basketbollit, tërheqje në hekur, vrapim i shpejtë vajtje ardhje 36m (40-yard), ulje-ngritje mbi duar (pompa), barkore, dhe vrapim 1600m (një milje); mos të jetë i martuar, të mos jetë nën obligim për t'u kujdesur për fëmijë; kandidatët nuk mund të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: kanë statusin aktiv (përfshirë edhe statusin e kadetit) si dhe rezervë të FSK-së, etj.



# SHBA do të rrisë bashkëpunimin reciprok me FSK-në

**A**tasheun e ri ushtarak nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kolonel Stephen Rose, i shoqëruar nga Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjenerallejtënant Rrahman Rama janë takuar në kryeministri me z.Avdullah Hoti, Kryeministër i Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, Kryeministri Hoti, duke i uruar mirëseardhjen Kolonelit Rose, nënvizoi faktin se bashkëpunimi bilateral është tepër i rëndësishëm në avancimin e mëtutjeshëm të aspiratave të FSK-së, e cila mbetet e përkushtuar që të jetë ndërvepruese me ushtritë mike dhe e integruar në NATO, ndihmën e së cilës Kosova nuk e harron kurrë dhe e çmon



përherë. Në anën tjetër, Koloneli Rose, duke e vlerësuar Kryeministrin Hoti për mirëpritjen, ndër të tjera, tha se është kënaqësi që të

japë kontributin e tij në Kosovë, duke u përkushtuar për thellim të bashkëpunimit të mëtejshëm dhe me interes reciprok.

## NË KOMANDËN E FORCAVE TOKËSORE NË ISTOG

### FSK, forcë multientnike në shërbim të qytetarëve

**N**ë Komandën e Forcave Tokësore në Istog, ishte për vizitë zëvendësministria e Mbrojtjes, Sadika Kofrc. Ajo u prit nga stafi udhëheqës i KFT-së i kryesuar nga komandanti i saj, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, i cili e njoftoi me zhvillimet e përgjithshme aktuale të komandës dhe njësisive vartëse të saj si dhe të arriturat e gjithmbarshme. Prezentimi përkatës u pasua me demonstrimin praktik të shkathtësive taktike nga njësitet e Regjimentit të Dytë të Këmbëorisë. Më pas, zëvendësministria Kofrc, me delegacionin e saj, u takua me pjesëtarët dhe pjesëtarët e FSK-së nga radhët e komuniteteve jo shumicë të njësisë përkatëse. Nga ta ajo u njoftua me përshtypjet e tyre shumë të mira për sistemin organi-



zativ dhe funksional të njësisë, preokupimet e tyre si dhe çështjet tjera me interes për ta. Zëvendësministria Kofrc çmoi lart stafin koman-

dues të KFT-së dhe angazhimin e pjesëtarëve nga komunitetet jo shumicë në të gjitha aktivitetet. Ajo, në emër të ministrit Quni, shprehu zotimin se politikat ministrore janë dhe do të jenë në funksion të respektim të plotë të të drejtave të pjesëtarëve nga radhët e të gjitha komuniteteve duke e konfirmuar çdo herë se FSK është e të gjithëve dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallime etnike, racore e fetare. Gjatë vizitës, zëvendësministria Kofrc, shoqërohej nga shefja e zyrës për komunitete të Ministrisë së Mbrojtjes, Lejla Loci, këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Hamdi Pollomi, zyrtarja e lartë e kabinetit të ministrit, Martina Dedaj-Kqira dhe major Fadil Vojvoda.



# Maqedonia e Veriut kontribuon në sigurinë Euro-Atlantike

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg priti në Selinë e NATO-s në Bruksel, më 8 tetor 2020, Kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, Ministria e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Bujar Osmani. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në konferencën e shtypit, ka përshëndetur anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO në 27 mars 2020 si një arritje e shquar “pas viteve të vendosmërisë dhe angazhimeve për reformë”. “Është mirë për njerëzit e Maqedonisë së Veriut”, tha ai “dhe kontribuon në sigurinë Euro-Atlantike”. Ai falënderoi Maqedoninë e Veriut për kontributin e saj të vlefshëm në misionet e NATO-s në Afganistan dhe në Kosovë dhe përshëndeti angazhimin e saj për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes në 2% të PBB-së deri në 2024.

Gjatë pandemisë COVID-19, Maqedonia e Veriut përfitoi nga mbështetja e aleatëve me shpërndarjen e pajisjeve mjekësore dhe ndihmës financiare për të lehtësuar barrën në sistemin e kujdesit shëndetësor. Përveç kësaj, Sekretari i Përgjithshëm njoftoi se Maqedonia e Veriut do të marrë një paketë ndihme COVID-19 nga rezervat e reja mjekësore të NATO-s, duke përfshirë 60 ventilatorë dhe pajisje të tjera të nevojshme urgjente me vlerë rreth 1.4 milion euro. “Ky është solidariteti i NATO-s në veprim”, tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai më tej përsëriti gatishmërinë e Ekipëve Mbështetëse Kundër-Hibrider të NATO-s për të ndihmuar vendet aleate për të adresuar kërcënimet e vazhdueshme kibernetike dhe hibride, duke përfshirë aktivitete dezinformuese. “Në të njëjtën kohë, sfidat e sigurisë me të cilat u përballëm para pandemisë nuk janë zhdukur. Ne jemi duke iu përgjigjur kërcënimeve hibride dhe kibernetike, përfshirë dezinformimin që synon institucionet tona, vlerat tona dhe demokracitë tona. NATO është këtu për të ndi-



Maqedonia e Veriut do të marrë një paketë ndihme COVID-19, nga rezervat e reja mjekësore të NATO-s, me vlerë rreth 1.4 milion euro.



hmuar aleatët. Ekipet tona të reja Mbështetëse Kundër-Hibrider janë të gatshme të ndihmojnë aleatët që të kundërshtojnë një gamë të gjerë sulmesh hibride. NATO nuk do të lejojë që kjo krizë shëndetësore të bëhet një krizë sigurie. Cilado qoftë sfida, ne jemi më të fortë dhe më të sigurt së bashku”.

„Maqedonia e Veriut është e përkushtuar në detyrimin për të investuar energji në unitetin dhe solidaritetin aleat dhe për të forcuar kapacitetet tona të sigurisë kombëtare,” tha kryeministri Zoran Zaev dhe shtoi se Maqedonia e Veriut vazhdon të jetë një nxitës i fortë i bashkëpunimit rajonal dhe dialogut politik dhe mbrojtës.

Në konferencën për shtyp, kryeministri Zaev tha se vizita në selinë e Aleancës, si vizita e tij e parë zyrtare ndërkombëtare në fillim të mandatit të dytë, konfirmon angazhimin për pjesëmarrje aktive dhe përmbytjen e detyrimeve që rrjedhin nga

anëtarësimi ynë në NATO.

„Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO ripërcakton rolin tonë në arenën ndërkombëtare të sigurisë, duke na mundësuar që të marrim pjesë aktive në gamën e gjerë të konsultave të sigurisë që përcaktojnë konceptin e NATO-s për mbrojtjen kolektive. “Ne kemi materializuar këtë qëllim strategjik të politikës së jashtme dhe kemi çimentuar bazat për rritjen e stabilitetit dhe prosperitetit të vendit tonë në një kohë rrethanash sfiduese që provojnë aftësinë e NATO-s për t’u transformuar dhe përshtatur”, tha kryeministri Zaev dhe shtoi se edhe përkundër sfidave ndaj ekonomisë për shkak të pandemisë, ne mbetemi të vendosur për të rritur buxhetin e mbrojtjes me 0.2% dhe për të arritur 2% të PBB-së deri në 2024 për të forcuar kapacitetin si kontributi ynë për ndërveprimin me aleatët e tjerë të NATO-s.



## MINISTRJA E MBROJTJES RADMILLA SHEKERINSKA

# Anëtarësimi në NATO-një kapitull i kurorëzuar me sukses

Vendi ynë është deklaruar se dëshiron të bëhet anëtar i NATO-s në një kohë kur shumica e të pranishmëve këtu, të gjithë ju studentë, nuk ishit lindur akoma. Kjo ëndërr zgjati shumë. Duhej ta lëviznim këtë maratonë të gjatë deri në fund, sepse edhe shteti, edhe qytetarët, e posaçërisht të rinjtë, prisnin dhe ishin lodhur nga ato pritje të dështuara. Kjo qeveri dhe kjo skuadër kanë vendosur që status quo-ja duhet të ndryshojë dhe se duhet të bëjmë një hap përpara. "Dhe me të vërtetë ndodhi, vendi ynë u bë anëtar i NATO-s," tha ministria e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska në një fjalim drejtuar studentëve të sapo regjistruar në Fakultetin e Sigurisë në fillimin zyrtar të vitit të ri akademik dhe festimin solemn të orës së parë akademike.

Shekerinska theksoi se



Ne jemi vërtet të gatshëm ta ndryshojmë vendin për më mirë për t'i merituar dhe për të siguruar sigurinë e NATO-s dhe prosperitetin evropian për të gjithë ne.

anëtarësimi në NATO është një kapitull që ne e kemi kurorëzuar me sukses, por tani po hapim një të ri. "Flamujt e BE dhe NATO pranë flamurit maqedonas nuk tregojnë vetëm fjalë, ato tregojnë se ne jemi vërtet të gatshëm ta ndryshojmë vendin për më mirë për t'i merituar dhe për të siguruar sigurinë e NATO-s dhe prosperitetin evropian për të gjithë ne," tha ministria.

Duke folur për rolin e sigurisë në kohën e re dhe mundësitë e ofruara në kurrikulën e re për

studim, ministria Shekerinska nënvizoi se siguria është, siç tha ajo, edhe nëse shteti do të jetë në gjendje të merret me epidemi siç ajo që kemi tani. "Gjithashtu është siguri nëse shteti do të jetë në gjendje të përshtatet me sukses ndaj ndryshimeve klimatike, nëse do të sigurojë ushqim në dispozicion dhe cilësor, nëse do të mbrojë sistemet e kompjuterike, nëse do të na mbrojë nga ndërhyrjet e vazhdueshme si në privatësinë tonë ashtu edhe në të drejtat tona," tha ministria.

# Inxhinierja kanadeze që punon për teknologjitë e NATO-s në hapësirë

Laryssa Patten punon në shkencën dhe teknologjinë hapësinore për mbi 20 vjet për Agjencinë Kanadeze të Hapësirës dhe drejtimin e operacioneve për Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës

Laryssa Patten është një inxhinierë dhe eksperte kanadeze e hapësirës që punon në Agjencinë e Komunikimit dhe Informacionit të NATO-s (NCI). Së bashku me ekspertë nga aleatët e tjerë të NATO-s, ajo ndihmon në rritjen e teknologjive dhe shërbimeve hapësinore të NATO-s. Laryssa ka punuar në shkencën dhe teknologjinë hapësinore për mbi 20 vjet. Kjo përfshinte operimin në satelitë për Agjencinë Kanadeze të Hapësirës dhe drejtimin e operacioneve për Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës. "Unë kam trajnuar astronautë që të përdorin krahun robotik në stacionin hapësinor", thotë Laryssa. "Në orbitë, astronautët e përdorën atë për të manovruar përbërës të mëdhenj nga anija kozmike në pozicionin në Stacionin Hapësinor. Ishte një nga kujtimet e mia më të mira". Sot, në Agjencinë NCI, udhëheqësja teknologjike e Aleancës, Laryssa përqendrohet në punën e saj në rritjen e aftësisë së NATO-s për të ndarë inteligjencën, qofshin figura apo të dhëna, midis të gjitha vendeve anëtare. Kjo aftësi kritike mbështetet nga asete të bazuara në hapësirë, siç janë satelitët. Mbrojtja kolektive, reagimi ndaj krizave, ndihma ndaj katastrofave dhe kundër-terrorizmi, të gjitha përdorin informacionin e dhënë nga dhe përmes hapësirës. Hapësira mbështet aftësinë e NATO-s për të lundruar dhe gjurmuar forcat, për të pasur komunikime të fuqishme, për të zbuluar lëshimet e raketave dhe për të siguruar komandim dhe kontroll efektiv. Më shumë se 2,000 satelitë aktualisht rrotullohen rreth Tokës, rreth gjysma e të cilave janë në pronësi të vendeve anëtare të NATO-s. "Edhe jeta jonë e përditshme varet nga hapësira më shumë sesa mund të mendoni," shpjegon Laryssa. "Bankat dhe navigimi mbështeten në satelitët GPS në hapësirë. Transmetimet, aviacioni dhe parashikimet e motit përdorin të gjitha mjetet hapësinore." Kjo vartësi dhe kërcënime të tjera krijuan një mjedis ku aleatët e NATO-s pranuan se hapësira është një çështje sigurie gjithnjë e më e përbashkët. Në 2019, NATO shpalli hapësirën një fushë të re operacionale, krahas tokës, ajrit, detit dhe

hapësirës kibernetike.

## Të mbrohet avantazhi teknologjik i NATO-s në hapësirë

Aftësitë hapësinore po bëhen më të përparuara, inovative, të përballeshme dhe të arritshme. "Ne po përjetojmë një rritje eksponenciale të aktivitetit," shpjegon Laryssa. "Ne duhet të sigurohemi që NATO e ruan avantazhin strategjik dhe kjo kërkon që ne të ecim në hap me ndryshimet e shpejta në fushën e hapësirës". Angazhimi i rritur i Aleancës në hapësirë do të rezultojë në kërkesë më të madhe për shërbimet hapësinore të NATO-s, duke kërkuar një qasje të re. Kjo është arsyeja pse Laryssa po udhëheq gjithashtu ngritjen e një qendre të re të teknologjisë hapësinore të NATO-s për të përqendruar përpjekjet e teknologjisë dhe ofrimit të

shërbimeve në një zonë të vetme. "Kjo do të na lejojë të adresojmë kërkesat e hapësirës përmes një pike qendrore. Dhe kjo do ta bëjë më të lehtë për NATO-n dhe industrinë të punojnë së bashku". Ajo po punon me Bordin Mbikëqyrës të Agjencisë, i cili përbëhet nga të gjitha 30 vendet anëtare të NATO-s për të përcaktuar rrugën më të mirë për të marrë për të nisur qendrën. Laryssa gjithashtu menaxhon rolin e Agjencisë në një aftësi tjetër kritike të NATO-s: sistemi i Aleancës Ground Surveillance (AGS), një aftësi e bazuar në pesë avionë të pilotuar në distancë dhe stacionet e komandës dhe kontrollit tokësor me burim evropian.

## Gëzimi i fëmijëve për shkencën

Pasioni i Laryssa-s për këtë kufi të ri shkon përtej punës. Ajo pëlqen





## Admirali Rob Bauer zgjidhet Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s

të promovojë hapësirën në kohën e saj të lirë duke ndarë njohuritë dhe energjinë e saj në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STEM) ngjarje të organizuara për fëmijë, duke zhvilluar profesionistët e teknologjisë hapësinore për të ardhmen. "Hapësira është një temë që mund të frymëzojë këdo. Fëmijët janë kuriozë për hapësirën, yjet, planetët, raketat, astronautët dhe më shumë", shpjegon Laryssa. "Ky kuriozitet, i kombinuar me ëndrrat dhe imagjinatën e fëmijëve, është shumë i fuqishëm." Në fillim të vitit 2020, Laryssa u bashkua me dritën e gjelbër për vajzat, një organizatë ndërkombëtare që frymëzon vajzat të ndjekin lëndët STEM, dhe partnerë të tjerë për të organizuar një ngjarje falas të të mësuarit interaktiv për t'i nxënë studentët të ngazëllyer për hapësirën. Më shumë se 100 vajza nga disa shkolla në Hollandë, të moshës 7 deri 12 vjeç, morën pjesë në një ditë të mbushur me workshop-e të drejtuara nga partnerë dhe mbështetës të ngjarjes, duke përfshirë Agjencinë Evropiane të Hapësirës, Policinë Hollandeze dhe Gratë në Aviacion (Hollandë). Laryssa drejtoi seminarin e Agjencisë NCI, ku pjesëmarrësit ndërtuan dronë me tulla LEGO dhe eksperimentuan me robotë. "Më pëlqen t'u flas fëmijëve për hapësirën, sepse ata lidhen me të dhe energjizohen nga ajo," pohon Laryssa. "Kjo është një mënyrë për t'i bërë ata të mendojnë për mundësitë për karrierën e tyre të ardhshme dhe për t'i mbajtur ata të interesuar për hapësirën dhe shkencën në përgjithësi," përfundon ajo.



Shefat e Mbrojtjes Aleate më 9 tetor 2020, zgjodhën Admiralin Rob Bauer, Shefin e Mbrojtjes së Forcave të Armatosura Hollandeze, për të qenë Kryetari i ardhshëm i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Këshilltar i lartë ushtarak i Sekretarit të Përgjithshëm. Admiral Bauer do të marrë pozitën pas përfundimit të mandatit të Shefit të Ajrit Marshall Sir Stuart Peach në qershor 2021. Shefi i Ajrit Marshal Peach mirëpriti zgjedhjen e Admiralit Bauer. "Urime Admiralit Rob Bauer. Ai do të jetë një Kryetar i shkëlqyeshëm i Komitetit Ushtarak të NATO-s. Udhëheqja e tij e fortë e Forcave të Armatosura Hollandeze dhe këshillat dhe udhëzimet e tij të qarta gjatë takimeve të Komitetit Ushtarak janë demonstrime të angazhimit dhe aftësive të tij. Nuk mund të dorëzoja Kryetarin tek një kandidat më i përshtatshëm.", tha Marshall Sir Stuart Peach. Duke folur pas zgjedhjes së tij, Admirali Bauer tha se "Unë e konsideroj një nder të jashtëzakonshëm që jam zgjedhur për të qenë Kryetari i ardhshëm i Komitetit Ushtarak. Jam i ngazëllyer për të marrë këtë sfidë në një kohë kaq të rëndësishme për NATO-n. Në këtë kohë kërcënimesh dhe sfidash gjithnjë e më komplekse të sig-



urisë, ne duhet të ruajmë kohezionin brenda aleancës. Ne kemi nevojë për të siguruar reagimin, gatishmërinë dhe përforsimin e NATO-s".

Ai theksoi më tej se "Si Kryetar i Komitetit Ushtarak, unë do të përpiqem të mbajmë së bashku veriun, jugun, lindjen dhe perëndimin, të mëdhenj dhe të vegjël; ndërsa ndjek një qasje 360 gradë për të parandaluar të gjitha kërcënimet e mundshme dhe për të mbrojtur aleatët kundër çdo kundërshtari". Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s është tradicionalisht një ish Shef i Mbrojtjes i një anëtarit aleat të NATO-s. Pozicioni i Kryetarit normalisht mbahet për një periudhë tre vjeçare. Shefat e Mbrojtjes, në një takim të mbyllur, zgjedhin Kryetarin e tyre nga kandidatët e paraqitur nga aleatët. Pozicioni i Kryetarit të Komitetit Ushtarak është mbajtur deri më tani nga 19 ushtarakë/oficerë (duke numëruar që nga viti 1963) nga Kombet e mëposhtme: Gjermania (pesë herë); Mbretëria e Bashkuar (katër herë); Kanadaja, Italia dhe Norvegjia (dy herë); Belgjika, Republika Çeke, Danimarka dhe Holanda (një herë).

# Autorë ushtarakë

## Në kuadrin e muajit të letërsisë

### Ilmi Qazimi, komisar i debateve dhe fabulist

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

#### Komisari që s'pranonte "lepe, peqe"

Ilmi Qazimi emërohet komisar në shkollën e Përgatitjes të Kuadrit Rezervist në Zall-Herr. Ai vinte nga Skrapari. Kishte mbaruar, së bashku me mjaft oficerë të zbulimit, dhe pse ishte përgatitur për këmbësori, kursin e shërbimit të informacionit. Ilmiu kishte qëndruar për një kohë të gjatë në detashmentin e zbulimit. Ai ishte i përgatitur, kishte nivel dhe me horizont të gjërë si ushtarak, por edhe për çështje të tjera të aktivitetit shoqëror. Në natyrën e punës së tij, kishte përparësi leximin e librave historik, të romaneve, të poezive, por dhe të librit me karakter ushtarak. Një e veçantë e tij ishte se nga dëshira për të folur, debatonte për mjaft probleme të ushtrisë, edhe ndryshe, apo të vendit në tërësi. Dallohej për korrektesë në kryerjen e detyrës së tij, por kishte mjaft të zhvilluar kërkesën e llogarisë. Më oficerët e rinj, kishte marrëdhënie shumë të mira.

Në natyrën e tij të punës shquheshin marrëdhëniet me vartësit, dinte të mbante balancë. Ndërsa në të kundërt, Ilmiu nuk e kishte mirë me eprorët, sepse nuk kishte qejf të konformohej me çdo kërkesë të tyre dhe të ishte në mënyrë të panatyrshme "lepe, peqe". Kishte sensin e të thënit të gjërave troç, ashtu siç ishin dhe si i mendonte ai vetë, pavarësisht se si i mendonin të tjerët. Me vonë, me një pjesë të oficerëve të Zall-Herrit, shkoi në Shkollën e Oficerëve Rezerv-



istë në Vaun e Dejës në Shkodër. Ai kishte një mënyrë të veçantë të të shtruarit të problemeve dhe ndiqej me interes nga të pranishmit, në diskutime, në mbledhje apo në analiza të punës. Ai dëgjohej me kujdes kur diskutonte dhe kur i shtronte problemet nisnin debate të zjarra... Kishte një llogjikë të veçantë, gati të "llogaritur" me të mirat dhe të këqijat në çdo çështje që shtronte për diskutim. Për këto cilësi të tij shkruan dhe komisar Gani Elezi në librin e tij "Kur përgatiteshim për mbrojtje" për karakterin dhe punën shembullore të Ilmi Qazimit.

#### Arsimimi dhe shkollat ushtarake

Ilmi S. Qazimi ka lindur më 10 qershor 1945, në Çepan të Skraparit. Me përfundimin e shkollës shtatëvjeçare në vendlindje, vijon të arsimohet pa ndërprerje në vitet

1959-1965 në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe të diplomohet e oficer këmbësori. Më tej ndoqi studimet në shkollën e diplomacisë, në Akademinë Ushtarake dhe në shkollën e Lartë të Partisë. Emërohet më punë në repartet ushtarake elitare të zbulimit me trupa në Ushtrinë Popullore shqiptare.

Për një kohë të gjatë ka ushtruar detyrën e komisarit në shkollave ushtarake të Përgatitjes të Oficerëve Rezervistë për ushtrinë në Tiranë dhe në Shkodër. Me ndryshimin e sistemit ekonomiko-shoqëror, reforma ushtarake e vitit 1992 e nxorri në lirim parakohe. Filloi të kryej detyra nga më të ndryshmet si roje, shitës ambulant, specialist biblioteke etj. Ai tani është në pension që nga viti 2006. Ai nga martesat ka katër fëmijë dhe është bërë gjysh gjashtë herë. Zotëron gjuhën angleze me të folur dhe me shkrim, si dhe gjuhën ruse elementet bazë.

#### Veprimtaria letrare e vonë... deri në SHBA

Në veprimtarinë e tij letrare përfshihen publicistikë në 37 organe të shtypit të të dy kohëve, përkthime nga gjuha angleze, poezi, pjesë humoristike, skica e tregime, artikuj monografike, kritikë letrare, pamflete, etj. Ka botuar librat me poezi: "I bukuri Çepan" në dy botime, "Mirëmbërëma Shqipëri", "Ftesë në të verdhë", "Tomorri në zemër", "Dielli sheh ëndrra, Hëna pikturon" dhe në prozë librin monografik "Çepani", monografitë "Kastriot Koçi - besniku fisnik" (me bashkautor Mehmet Dume), "Latif Fodulli", "Qemal Isa Koxhaj". Disa prej përjetimeve

nga Toronto, në Kanada, i ka shkruar në librin "Çokollata në ashensor" në vitin 2019. Ka publikuar shkrime në shtypin shqiptar të pas viteve 2000, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kroaci e Suedi. Punon për të nxjerrë në qarkullim disa libra studimorë dhe artistikë. Fabula është pasion i veçantë i tij.

### ...dhe detyra e shtëpisë


Së fundi Ilmi S. Qazimi vjen me librin me fabula "Bretkosa, akrepi, miu...". Tashmë komisari vjen si fabulist në një vëllim ku përfshihen në libër kafshë, shpendë, insekte dhe bimë. Në libër përshkruhen pjesë të trupit të njeriut, që "flasin" dhe "grinden" me njera tjetrën. Ato flasin e grinden për të na zgjuar mendimin dhe për nisur debatin si dikur. Më tej në libër vijnë në gjuhën e Ezopit për-ralla, gojëdhëna e ndodhi nga më të ndryshme. Fabulisti në faqet e fundit të fabulave ka dalë nga "pyllit" me kafshë e shpendë, dhe na ka dhënë fabula të një karakteri krejt tjetër, të gjitha interesante.

Dhe fabulat më të arrira në këtë libër mendoj se janë: fabula "Bleta dhe miu" ndjek një alegori, ku lexuesit i bie në sy një dukuri e tillë, ku autori nëpërmjet bletës dhe miut zbulon njeriun. Fabula të shpie tek të pabesët, të cilët tashmë nuk janë të paktë. Miu futet në koshere, mirëpo aty gjen gatishmërinë e bletëve të cilat e asgjësojnë në saj të vigjilencës.

Fabula "Bretkosa dhe akrepi" autori sjell plot mlllef për shkak të plagëve të kohës, për shkak të këtyre plagëve që s'po gjejnë shërim, ai që bën mirë, gjen keq. Autori flet, por më shumë bërtet e godet. Njeriut të keq, bëji mirë sa të duash, përsëri ai të godet, të vret, kështu e pësoi dhe bretkosa nga akrepi, duke kaluar lumin, kur akrepi i thotë nuk rri dot pa pickuar se e kam në natyrë. Ndërsa në fabulën "Delja dhe cjapi", autori ngacmon mburracakët, ata që pa punuar krekosen, në mes të ditës. Tërë vëmendjen autori e përqëndron tek cjapi kur delja i thotë që brirë të mos kesh, sepse cjapi çdo gjë e zgjidh me forcë, me anët e brirëve duke goditur. Në fabulën "Korbi dhe breshka" autori godet me forcë njerëzit llafezanë që nuk

shikojnë punën e tyre por tallen me punën e të tjerëve, me mundin dhe djersën e tyre. Nëpërmjet përgjigjes së breshkës që ju thotë mos shikon si unë lëviz, godet një plagë të shoqërisë, e cila në vend të punës dhe të ndryshimit të gjërave për mirë, merren me prishje dhe me llafe të pafundme. Kjo është një plagë e shoqërisë shqiptare sot.

Në fabulën "Sita dhe shosha" një gjetje orgjinale, ku si sita dhe shosha si përroi me lumin, flet për një plagë të madhe shoqërore, ku njerëz të pangopur nga pasuria dhe lakmia shikojnë si pasurojnë njeri-tjetrin



dhe luftojnë e luftojnë duke u zënë me njeri tjetrin për pasuri. Fabula "Rrëfen gjarpri" nëpërmjet dredhisë, kafshimit dhe helmimit të gjarprit, autori e vendos një lloj tërësisht si me njeriun. E veçanta e fabulës është se gjarpri lëkurën e ndërton një herë në vit, ndërsa ca njerëz e ndërrojnë lëkurën çdo ditë.

Në fabulën "Monologu i ujku" tregon se nofkën "egërsirë" thotë ujku, ma ka vendosur njeriu, pasi nëpërmjet kësaj fytyrën e tij deshi të mbulonte. Më tej monologu vazhdon se njeriu nuk mundi të vlerësonte dhe kafshët e tjera, se veç kjo e mbulonte, mjafton që ujku bën kerdinë... Këtu mbaroi detyra e shtëpisë, pasi në librin që më dhuroi fabulisti Ilmi S. Qazmi më kërkonte shtatë fabulat më të arrira, këto sipas gjykimit tim

janë më të mirat.

### Mesazhet që na jep fibula

Qesh e ngjesh, humor dhe tinguj dhimbje. Autori si detyrë nëpërmjet fabulave na argëton, por dhe na bën të qeshim. Ai nëpërmjet tyre ka aritur që lexuesin ta çojë në mendime, në debate, në gjykime për kohën, ai e trishton, por dhe e revoltion lexuesin. Nëpërmjet revoltës ai kërkon të ngremë zërin për mjaft probleme të shoqërisë së sotme. Në mjaft fabula autori i ka në katër vargje, por që jep shumë mendime dhe ide për shoqërinë.

Shkrimtari Ilmi Qazimi na paraqitet një krijues me inteligjencë në fabula. Ai si një njeri i vëmendshëm ndaj çështjeve të vogla, detajeve të shoqërisë vazhdon të qëmtojë fenomene dhe ndodhi të njeriut, por të përcjella tek kafshët dhe insektet. Ai e ka jetuar dhe vazhdon ta jetojë kohën, duke i përfshirë në libër atë që e shqetëson qytetarin e thjeshtë. Kështu ish ushtaraku futet në detaje të thjeshta, por që marrin vlera kur i analizon dhe i diskuton gjerësisht.

Nëpërmjet fabulave dhe tregimeve të shkurtër kupton se autori na ka zbritur në terrenin konkret të shoqërisë shqiptare. Lexuesit i mbetet vetëm që nëpërmjet emrave të kafshëve, të dali në emra konkret të njerëzve. Në shumicën e fabulave ka fjalë që ironizojnë dhe ironira që flasin me gjuhën e kafshëve. Autori është shprehur me gjuhë të thjeshtë dhe me figura, duke u bërë kështu të flasë me një gjuhë popullore, ai ironizon ata njerëz që janë në detyra të ndryshme të caktuar nga shoqëria, por që synojnë e orvaten të përfitojnë nga taksat e popullit, duke u bërë të pangopur, e duke u përfshirë në shumë borde e komisione të ndryshme.

Autori në fabula na nxjerr se kafshët kuptohen me njëra-tjetrën, ndryshe ndodh me njerëzit, flasin por nuk mirren vesh. Kjo dukuri vazhdon gjatë gjithë librit me fabula. Në çdo fabul, nga jeta e përditshme mund të gjesh në mënyrë konkrete njeriun e ditëve të sotme. Nëpërmjet këtij libri të ri Ilmi Qazimi na paraqitet jo vetëm fabulis, por edhe një qytetar shoqëror.



## Dëshmorët e Gramshit, që ranë për truallin shqiptar në Shkodër

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Lufta për mbrojtjen e Shkodrës është zhvilluar nga 19 tetor 1912 deri më 22 prill 1913, në një nga trevat ku përballja luftarake ka qenë e gjatë e përgjakshme, heroike dhe që në fakt u mbyll pa lavdi por me tradhëti nga Brenda. Lufta e Shkodrës ka qenë luftë madhore e shqiptarëve vullnetarë, që për kohën quheshin "vetëdashës" duke përfshirë edhe një divizion të trupave osmane që kryesohej nga Hasan Riza Pasha kundër shovinistëve malazezë që donin të aneksonin Shqipërinë Veriore. Trupat malazeze ishin pjesë e një mbretërie të vogël por me mbështetje të madhe slave. Ato kishin një epërsi të madhe në njerëz, armatim e municione, topa të kalibrit të rëndë si dhe materiale të tjera mbështetëse ushtarake. Luftimet më të rëndësishme u zhvilluan në malin e Taraboshit, në kodrat e Beltojës, Bërdicës, e Bardhonjorëve. Në këto luftime ushtritë malazeze lanë rreth tetëmbëdhjetëmijë të vrarë, ndërsa forcat mbrojtëse patën rreth dymijë të vrarë dhe rreth dymijëepesëqind të plagosur. Megjithatë, për shkak të qëndrimit tradhtar të komandantit të forcave shqiptare Esat Toptani, forcat armike hynë në qytet dhe e pushtuan Shkodrën më 22.4.1913. Ka qenë një dorëzim i çelësave të qytetit të Shkodrës në mënyrë të pabesë si dhe një tradhëti e hapur e gjakut të derdhur të dëshmorëve. I vetmi "përfitim" i shqiptarëve ishte që të dilnin nga Shkodra me armatimin e tyre personal të pangacmuar nga ushtarët malazezë. Edhe pas pushtimit të përkohshëm, vazhdoi qëndresa kundër pushtuesve që ishte një konflikt i përgjakshëm për jetë a vdekje. Historiografia shqiptare me të drejtë e ka cilësuar luftën për mbrojtjen e Shkodrës, 1912-1913, si "një ndër luftat më të gjata, më të përgjakshme e më të vështira të popullit shqiptar për sigurinë e tërësisë tokësore. Lufta e Shkodrës ka qenë tërësisht një luftë moderne dhe e mirorganizuar, një luftë në rrethim gjashtëmujor serbo-malazez, që përbën rastin më unikal të qëndresës heroike të shqiptarëve në Luftën e Parë Ballkanike e më gjerë". Erdhi viti 1914 dhe Shqipëria u bë shesh lufte. 250 mijë ushtarë shkelën tokën arbërore nga 8 ushtri italiane, greke, serbe, malazeze, bullgare, franceze, austro-hungareze. Gjaku i djemve shqiptarë që luftuan në Shkodër shkoi kot. Por edhe tipet e shteteve që erdhën dhe ikën nuk u kujtuan ose "harruan" burrinë shqiptare që kacafitej me çdo pushtues në veri dhe në jug, në lindje dhe në perëndim për të mbrojtur truallin që të parët jua kishin lënë si trashëgimi dhe si amanet të brezave. Vetëm Gramshi dhe rrethinat e fshatrave përreth luftuan trimërisht

(Kushtuar 2000 dëshmorëve të atdheut të rënë në Tarabosh, Shkodër e rrethinat e saj si dhe veçanërisht të rënëve të Gramshit Isa Hymet Bici, Jashar Vrekë Bici, Laze Mehmet Xhangoli nga Shënepremte/Lenie dhe Cane Dylber Përfundi nga Grabova e Poshtme, të cilët kanë rënë në mbrojtje të trojeve shqiptare në malin e Taraboshit në Shkodër në nëntor-dhjetor 1912 vetëm disa ditë pas shpalljes së pavarësisë shqiptare; si dhe dëshmorëve Tele Selim Bujku, Arif Sali Toska, Zyber Mehmet Rabo, Pasho Laze Braho, Hasan Dule Avdiu, Nexhip Rexhep Salla, Ibrahim Rushit Dollani, Sulejman Sadush Shaipi, Sulejman Cela, Bilal Bajrami dhe Seran Murati që kanë rënë në shkurt marsin e vitit 1913 në luftimet e zhvilluara në zonën e Malësisë së Madhe, dhe të evidentuar nga Kryesia e Organizatës së dëshmorëve të Gramshit)



duke lënë pesëmbëdhjetë të vrarë në front dhe rreth njëzetë të plagosur.

### Zëri kushtrim i të parëve edhe në Gramsh si në të gjithë Shqipërinë

Gramshi dhe fshatrat e saj nuk i harroi kurrë bijtë e vet që gjakun e derdhën betejave të historisë shqiptare. Bijtë që rrëmbyen armët për ta pritur hasmin me pushkë ishin të shumtë. Ata u përbashkuan me çetën e Elbasanit dhe së bashku luftuan në frontin ku ishte zëri i Atdheut. Me sy e veshë nga zhvillimet në Shkodër ishin të gjithë qeveria e përkohshme e Vlorës e sapokrijuar e drejtuar nga plaku i bardhë i flamurit Ismail Qemal Bej Vlora; me sy e veshë nga Shkodra ishte Labëria, Çamëria, Skrapari e Korça, Luma dhe Mirdita, Malësitë e Tiranës, Berati e Gjirokastra, Elbasani e Gramshi, e gjithë Shqipëria. Përgatitjet e ethshme për luftë të ushtrisë së Mbretërisë së Malit të Zi, u ndihmuan edhe nga trupat aleate serbe, që rrethuan Shkodrën. Kishte ardhur një moment dhe rast i volitshëm por shqiptarët nuk ditën

ta shfrytëzonin atë. Liga Ballkanike, e përbërë nga Serbia, Mali i Zi, Greqia e Bullgaria i kishin shpallur luftë Perandorisë Osmane. Në emër të luftës kundër osmanëve, Mbreti i Malit të Zi, Krajl Nikolla, mund të bënte realitet një ëndërr të vjetër, të zgjeronte territoret e mbretërisë duke pushtuar qytetin e Shkodrës bashkë me rrethinat. Por Osmanët të mbështetur nga vullnetarët shqiptarë nuk donin ta lëshonin qendrën historike të vilajetit shqiptar. Për këtë grumbullojnë forca të shumta, logjistikë e rezerva për rezistencë luftarake të gjatë. Edhe djemtë e Gramshit erdhën vullnetarë në Shkodër. Predhat e topave malazezë ranë mbi Shkodër, rrethinat e saj dhe mbi luftëtarët mbrojtës. Përleshjet midis malazezëve e serbëve, nga njëra anë, dhe mbrojtësve turq e shqiptarë, nga ana tjetër, do të vazhdonin për më shumë se pesë muaj. Luftimet në terren janë të njohura, që janë të dokumentuara edhe nga konsujt e huaj që ishin të atashuar në Shkodër dhe që kanë mbajtur ditar për tmerrret e kësaj lufte të pabarabartë. Të mbijetuarit përveç luftës duronin edhe betejën e përditshme për t'u siguruar një kore buke apo një grusht miell fëmijëve, që nisën të vdisnin nga uria. Një kalvar i tmerrshëm dhe ekstrem plot vuajtje e banorëve myslimanë e të krishterë të Shkodrës. Por nga ana tjetër luftëtarët shqiptarë e osmanë bashkë në një xhephane lufte përballonin luftën, urinë, të ftohtin si dhe shokët e rënë dhe të varrosur direkt në llogore, sikurse janë mbuluar me dheun e lehtë të tokës mëmë edhe pesëmbëdhjetë bij të Gramshit dhe fshatrave përreth.

### **Të rënë për atdhe - përjetësisht në memorie të kombit**

Janë lumenj gjaku, janë sakrificat të panumërta, janë jetë të humbura, janë dhimbje e lot nënash shamizeza, që nuk rreshti loti në faqe, sikurse loti në trupin e drobitur të hallemadhes shqipëri nuk rreshti. Toka në Tarabosh, në Malësi të Madhe e kudo në Shkodër u mbryjt me gjak dëshmor, me gjakun e atyre që ende nuk kanë gjetur qetësi dhe nuk kanë marrë vlerën që ju takon minimalja e minimaleve vlerësimin me titullin e lartë të dëshmorit. Nderimi me titullin "dëshmor", në radhë të parë është nderim për historinë e shtetit dhe të institucioneve të tij, që me aq mund e sakrificat u ngritën më 1912-ën, që fuqitë e madha aprovuan kufijtë e sotëm shqiptar në korrik të vitit 1913 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, dhe sërish në Londër dy vjet më vonë përsëri miratuan një traktat të fshehtë për coptimin e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Por gjaku nuk mund të bëhet ujë. Prandaj bazuar në dokumentacionin e shumtë të zonës së Gramshit dhe jo vetëm që është mjaft i e vërtetues, por mbështetur juridikisht në Ligjin e ri nr. 109/2018, datë 20.12.2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", nenin 5 "Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i Atdheut" pika "b)" shtetasit shqiptarë e të huaj, të cilët kanë rënë në luftë për mbrojtjen e integritetit territorial, të lirisë e pavarësisë së Shqipërisë, si dhe për arsye të kundërshtimit të pushtimit të trojeve shqiptare nga ushtritë e huaja dhe të qëllimeve shoviniste të tyre, nga data 28 nëntor 1912 deri më 7 prill 1939; si dhe pika "c)" "shtetasit shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën në mbrojtje të vlerave kombëtare epatriotike të kombit shqiptar para datës 7 prill 1939", gjykojmë që pesëmbëdhjetë të rënë e Gramshit dhe zonave përreth të mundësohet shpallja e tyre "Dëshmor i Atdheut" dhe më konkretisht: Isa Hymet Bici i lindur më 1885 në Shënepremte/Lenie dhe rënë më 30.11.1912 në Tarabosh të Shkodrës, në moshën 27 vjeçare; Jashar Zerkë Bici, i lindur më 1884 në Shënepremte/Lenie dhe rënë më 30.11.1912 Tarabosh, në moshën 28 vjeçare; Laze Mehmet Xhangoli i lindur më 1885 në Shënepremte/Lenie dhe rënë më 1.12.1912 në Tarabosh, në moshën 27 vjeçare; Cane Dylber Përfundi i lindur më 1882 nga Grabova e Poshtme dhe rënë më 3.12.1912 në Tarabosh të Shkodrës, në moshën 30 vjeçare, që të katërt i përkasin

të rënëve të vitit të pavarësisë të 1912-ës. Në luftimet e ashpra për Shkodrën dhe trevat e saj përreth luftuan dhe ranë për atdhe edhe djem të tjerë të Gramshit dhe rrethinave të saj sikurse janë: Tele Selim Bujku i lindur më 1884 në Bulçari të Gramshit dhe që ra mars 1913 në moshën 29 vjeçare; Arif Sali Toska i lindur më 1887 në Zamsh dhe rënë në mars 1913 në moshën 26 vjeçare; Sulejman Çela i lindur më 1885 në Gramsh fshat dhe që ka rënë mars 1913 në moshën 28 vjeçare; Zyber Mehmet Rabo i lindur më 1885 në fshatin Drizë dhe rënë për atdhe në mars 1913, në moshën 28 vjeçare; Pasho Laze Braho i lindur më 1889 në fshatin Tunjë dhe që ka rënë në mars 1913 në moshën 24 vjeçare; Hasan Dule Avdiu i lindur më 1889 në Lubinjë dhe që ka rënë mars 1913 në moshën 24 vjeçare; Nexhip Rexhep Salla i lindur më 1889 në Lubinjë dhe që ka rënë në mars 1913 në moshën 24 vjeçare; Bilal Bajrami i lindur më 1886 në fshatin Sult dhe që ka rënë në mars 1913 në moshën 27 vjeçare; Seran Murati i lindur më 1888 në fshatin Sult dhe që ka rënë në mars 1913 në moshën 25 vjeçare; Ibrahim Rushit Dollani i lindur më 1883 në Jançë dhe ka rënë mars 1913 në



moshën 30 vjeçare; Sulejman Sadush Shaipi i lindur më 1887 në fshatin Dufshan dhe ka rënë në mars 1913 në moshën 26 vjeçare. Thënia proverbial, por profetike shkodrane se kush ka ra për Atdhe nuk ka vdekun por ka le" është materializuar në një ndër luftrat më vitale dhe më të gjata të shqiptarëve sikurse ka qenë mbrojtja e Shkodrës në një ndër momentet me decisive kur në Londër diskutohej që të vendosej fati i kufijve administrativë shtetërorë shqiptarë, që shumica e "miqve", që në fakt ishin armiq të shqiptarëve e donin Shkodrën jashtë Shqipërisë, të papërfshirë në ndarjen administrative të 29 korrikut 1913. Por fitoi variant austro-hungarez dhe Shkodra ngeli shqiptare dhe Gjakova jashtë trojeve shqiptare por mbrekullisht shpëtoi nga UÇK-ja dhe ndërhyrja e NATO-s më 1999. Kjo ishte rruga që shtruan me gjak dëshmorët e të gjitha kohrave, ku mosha mesatare e dëshmorëve ishte rreth 26 vjeç. Kjo ishte rruga e bindjes përmes gjakut për lirinë edhe për Fuqitë e Mëdha të kombeve, që ora e interest ka prevaluar mbi të drejtën e kombeve të vegjël.

### **Djemtë e Gramshit pjesë e ndërgjegjes kombëtare të Shqiptarëve**

Gramshi dhe djemtë e saj provuan edhe një herë menjëherë pas shpalljes së pavarësisë se janë pjesë thelbësore e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve me mençurinë dhe trimërinë e treguar në mbrojtjen e çdo pëllembe tokë të trashëgimisë së të parëve. Edhe djemtë e tjerë luftëtarë të kësaj treve u përbashkuan me idealin e luftëtarëve për mbrojtjen e tokës arbërore në kufijtë e saj të Shkodrës që për Fuqitë e Mëdha ishin kufijtë shqiptarë e ndërkohë që vetë luftëtarët në front e dinin mirë se kufijtë shqiptarë të 1912-tës ishin kufijtë e katër vilajeteve shqiptare që ishin shkëputur tashmë nga Perandoria Osmane që po shkërmoqej gjithënjë e më shumë dhe nuk po mundej të mbante nderin e

saj gjashtëqindvjeçar si sulltanat dhe jo më të ishte e zonja që të mbronte tokat e shqiptarëve që me lufrat ballkanike kishin dalë në "ankand". Vetë shqiptarët po luftonin trimërisht në të gjitha frontet në veri dhe në jug të shqipërisë për të mos lejuar që trangu mëmë të sakatohej nga Fuqitë e Mëdha por edhe nga mbretëritë ballkanike të Greqisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Bullgarisë që kishin drejtuar tehun e veprimeve për të përfutur nga largimi dhe disfatat e njëpasnjëshme të osmanëve në hapësirat shqiptare ku ishin shtrirë dhe "kishin shirë" për një kohë të gjatë. Po sjellim një fakt se ku e ka burimin e hapur lakmia malazeze: Në vitin 1905 Kraj Nikolla i Malit të Zi takon Sulltan Hamitin dhe ai i kërkoi Sulltanit që t'i lëshojë pak vend në Tarabosh sa një lëkurë bualli". Sulltani e priti kërkesën me mospërfillje se "nuk do t'i jepte ndonjë gjë të madhe, vec një copëz shkëmb e gur taraboshi". Në takim ishte edhe Ramazan Bega nga Oblika e Anës së Malit, i cili ndërhyr dhe i thotë: "Naltmadhëni njëkëtu xen vend". Sulltani në të tijën: "Një copë shkëmb po i jap". Shqiptari i thotë: "Asht celës për Shkodrën, shuhet emni dhe s'ka më kala". Jo më kot kërkonte që më 1905 Kraji i Malazezëve "nji copë shkëmb", se prej andej niste sulmi përmbi Shkodër, sepse ushtarakisht dhe strategjikisht kush zotëronte Taraboshin zotëronte Shkodrën. Shkodra do të mbrohej nga dy vija mbrojtëse kryesorja ishin shpatet e malit të Taraboshit Kodrat e Bërdicës, Vukatane si dhe vija e dytë Kodrat e Tepesit, Bardhaj, bregu i lumit të Kirit, Golem Dobrac etj. Betimi i luftëtarëve në Shkodër sikurse edhe luftëtarëve të Gramshit ishte domethënëse: "Shja do të hysh në Shkodër kur këmbët tuaja të shkelin mbi shpinat tona". Nga të dhënat e degës së dëshmorëve të Gramshit evidentojmë se: "Djemtë e çetës së Elbasanit dhe Gramshit ishin të përbashkuar në luftimet për Shkodrën nën komandën e rreshterit Mehmet Hasan Hasa. Nga Shënepremtja ishin 13 luftëtarë ndërsa nga Grabova ishin 6 luftëtarë, ku ngelën përjetësisht në memorie të kombit katër dëshmorë dhe që të gjithë i përkasin të dy fshatrave ose sikurse thirrej fshati i madh i bashkuar i Shënepremtes.

### Gjaku që u derdh në themele të lirisë në Shkodër

Shumë djem të Gramshit u aktivizuan me çetën e kapedan Mahmut Xhelili dhe në fakt kanë shkruar faqe heroizmi dhe kanë treguar atdhetari të lartë. Këta luftëtarë dhe të tjerë pas tyre katuan "brumin" atdhetar të vazhdimësisë. Prandaj të sprovuar në beteja gramshiotët e treguan veten edhe në Shkodër, në Tarabosh dhe në Malsinë e madhe që me vitalitetin dhe energjinë e shqiptarit të vendosur i thanë "nda!" dhe "jo" pushtimit, deri sa Shkodra ra vetëm me tradhëti se nuk kishte asnjë lloj mënyre tjetër të mundshme të rënies. Luftëtarë redifë gramshiotë, që luftuan trimërisht në Shkodër ishin të shumtë si: Isa Hymet Bici, Jashar Vrekë Bici, Laze Mehmet Xhangoli, Cane Dylber Përfundi, Çerçiz Ajazi, Mustë Çekrezi, SHEME Çekrezi, Kame Çekrezi, Bido Çekrezi, Dape Çekrezi, Sulejman Çela, Mahmut Çela, Baze Çela, Mustafa Blogu, Musa Xhaferi, Musa Liçi, Bajram Liçi, Halim Liçi, Dalip Liçi, Xhemal Liçi, Cane Sejдини, Ramo Hida, Jaçe Brahimi, File Dervishi, Shahin Mema, Mete Mema, Mustë Llapushi, Hiqmet Llapushi, Xhelal Koçi, Arif Sali Toska, Pasho Laze Braho, Myslim Koçi, Selman Koçi, Mustafa Plaku, Qamil Elezi, Zyber Mehmet Rabo, Hasan Dule Avdiu, Nexhip Rexhep Salla, Ibrahim Rushit Dollani, Sulejman Sadush Shaipe, Kame Kotorri, Nebi Kotorri, Tele Selim Bujku, Dape Hazisi, Çaushe Daja, Bilal Bajrami, Seran Murati, Pelivan Daja... etj. Por gramshiotët që u sosën të gjallë pas luftimeve të vete tmerret e luftës dhe historinë se si i varrosën shokët e rënë dëshmorë për Shkodrën atje "ku i zuri balta", një zakon i trashëguar për luftëtarët që vriteshin në të gjitha anët e katër vilajeteve shqiptare në pamundësi të transportimit të trupave të tyre. Të gjallët gramshiotë sollën njëherazi edhe një këngë që vërtetonte tradhëtinë e Esat Top-tanit: "...Karadaku brigje-brigje,/digje Esat Pasha digje./Nuk e djeg se është i vogël,/do ta lë sa të vijë në Shkodër...". Ismail

Qemali e quajti këtë tradhëti: "atentat kundër shqiptarëve dhe pavarësisë së tyre!". Për trimat gramshiotë për dëshmorët e saj kënga nuk u shua kurrë. Kështu teksti i Abedin Bicit edhe sot dhe përgjithmonë vijon të jetë aktual për të rënë në Shkodër për Shqipërinë: "...Këmbdojmë për Lazen, Jasharin, Canen e Isanë,/Që jetën për mbrojtjen e Shkodrës e dhanë,/lule more djem që ratë për Atdhe...".

### Të vërtetat e luftës/rrethimit të Shkodrës

Djemtë luftëtarë të Gramshit dhe Elbasanit nuk dinin shumë gjera që lidheshin me luftën e vecanërisht me prapavijat e saj diplomatike e konjunkturat e kohës. Por një gjë e dinin mirë: Të mbronin tokën e vet të shenjtë. Në pranverë të 1912-ës, u arrit marrëveshja serbo-bullgare, në të cilën hynë në aleancë dhe Mbretëria malezeze dhe Greke në një aleancë "antiosmane". Për Shqipërinë dhe shqiptarët marrëveshja ishte një plan i ri pushtimi e copëtimi. Këta "aleatë" nuk vinin si çlirimtarë, por si pushtues. Serbët pushtuan Vardarin, Sanxhakun, Novi-Pazarin, Rrafshin e Dukagjinit dhe iu drejtuan Adriatikut. Grekët pushtuan Himarën dhe arritën në Qafë të Llogorasë. Malazesët sulmuan dhe rrethuan Shkodrën. Të njëjtën synim kishin Rusia, Austria, Italia, dhe sllavët e jugut, që donin pushtetin e tyre deri në Adriatik. Kraji Nikolla e kushtëzonte ekzistencën e Malit të Zi me Shkodrën, që e "ëndërronte" si kryeqytetin e Malit të Zi. Malazetët sulmuan ushtrinë osmane para se të reagonin Fuqitë e Mëdha, e në radhë të parë Austro-Hungaria. Mali i Zi, pa ndonjë traditë luftarake, u fut në lutim drejt Shkodrës



me 30 mijë trupa, më 8 tetor 1912. Lufta filloi e shoqëruar me një të shtënë me top në drejtim të Shkodrës, nga princi Mirko. "Kjo e shtënë sinjalizoi fillimin e luftës së Malit të Zi kundër Turqisë, por edhe atë të Luftës së Parë Ballkanike". Brenda javës, armatat e ushtrisë serbe dhe të Malit të Zi, në "sinkron" të plotë, filluan të pushtojnë tokat e Shqipërisë së veriut, drejt Shkodrës. Situata e rëndonin edhe disa malësorë të gënjer e të paguar. Fakt është se në mbrojtjen e Shkodrës, kanë marrë pjesë 24 mijë forca të osmane, nën komandën e Hasan Riza Pashës të dislokuara në 5 rajone: Rajoni Shtoj, Bardhaj, Bërdicë, Tarabosh, Tepe (që në turqisht do të thotë "kodër". Në ndihmë të tij, nën drejtimin e Esat Pashës, rreth qytetit ishin vendosur më shumë se 15 mijë mbrojtës rezervistë (redifë) shqiptarë, të ardhur nga rrethet Lezhë, Dibër, Mirditë, Krujë, Tiranë, Shijak, Durrës, Kavajë, Elbasan, Gramsh, Peqin, Pukë dhe Shkodër rreth 5 mijë luftëtarë. Shtabnikët osmanë me Hasan Riza Pashën kishin parashikuar çdo gjë që duhej për mbrojtjen e Shkodrës, ku mbi të cilën u derdhën mijëra predha e tonelata me hekur e zjarr. Në dhjetor 1912 dhe janar 1913, mali i Taraboshit, kodrat e Beltojës, Bërdicës dhe Bardhajve u bënë arenë luftimesh shumë të përgjakshme. Malin e Zi, mbështetëj fort nga Serbia, që më 10. 11. 1912 kaloi në ofensivë dy divizione: "Shumadija" me 6500 trupa e "Drina 2" me 9219 trupa, të niseshin njëri nga Prizreni për në Durrës dhe tjetri nga Gjakova për në Shëngjin, për të pushtuar Shqipërinë. Këto njësi serbe ndeshën në qëndresën e shqiptarëve. Malazetët e Nikollës kishin shpallur se: "do të luftonin deri në fishekun e



fundit për të marrë Shkodrën”, por që dështuan në të gjitha rastet që e provuan, përballë trupave osmane e shqiptare të përgatitura në fushën ushtarake, të armatimit e fortifikimit, duke treguar veprime energjike qëndrese të vendosura. Qindra shkodoranë, burra dhe gra, punonin për prapavijën, në hapjen e llogoreve, vendosjen e telave me gjemba, mbledhjen e rezervave ushqimore dhe lëndëve djegëse, transportin e materialeve luftarake, hapjen e rrugëve të reja, transportin dhe mjekimin e të plagosurve, qepjen e veshjeve për luftëtarët e lirisë etj. Komanda osmane shqiptare kishte vendosur raporte të mira me parinë e qytetit dhe Shkodra u mbrojt në dy vija mbrojtëse: nga shpatet e Taraboshit, kodrat në Berdicë dhe Vukatanë, kurse e dyta nga kodrat e Tepesë, Bardhajt, bregu i Kirit, Golem, Dobraq etj. Artileria ishte vendosur në Tarabosh, Berdicë, Tepe, Bardhaj e Shtoj. Fortesa nr. 1 e mbrojtjes së Shkodrës është mali i Taraboshit, kush mbronte Taraboshin, kishte në dorë Shkodrën dhe pikërisht në këtë kala të pakapërcyeshme ngelën përjetësisht atje katër dëshmorë të Gramshit. Luftimet për mbrojtjen ishin të lidhura me fortifikime të tipit fushor me vija e hendeklidhje, çka i dha siguri qëndresës së qytetit. Zonat më të sigurta ishin: Shtoji, Bardhaj, Taraboshi, Tepja, Berdica etj. Brenda garnizoni i Shkodrës ishte i mirëorganizuar me ndërlidhje, që nga centrali kryesor në kala, deri tek ato të rajoneve të mbrojtjes. Fillimisht në luftime nuk mungonin armatimi, ushqimet. Ndërkohë që më datën 3 dhjetor 1912 vendoset armëpushimi i parë, ku Nikolla urdhëroi ndërprerjen e luftimeve, por Hasan Riza Pasha u përgjigj se: “Tashmë Shkodra është një qytet shqiptar që nuk mund të marrë urdhra nga një komandë osmane dhe se qyteti dëshiron të mbrojë pavarësinë e vet, kundër malazezëve”. Shkodra mbrohej nën flamurin e saj shqiptar: Pashai osman deklaronte: “Shkodra mund të rezistojë edhe për gjashtë muaj të tjerë”. Pas dy ditësh më 5.12.1912, malazezët ndërmoren sulmin masiv nga Bardhaj deri në breg të liqenit të Shkodrës, sulm që përfundoi në përleshje trup me trup, me thika, bajoneta, ndërkohë që xhephane e Shkodrës bë tymb e flakë nga zbrazja e pushkëve, mitralozave dhe topave. Kur zbardhi dita, në fushën e betejës kishin mbetur qindra malazezë të vrarë dhe të varur në tela, llogore dhe transhe. Fatin e luftimeve e vendosi artileria osmane, e cila sulmoi fuqishëm në të gjitha pozicionet. Shkodra qëndroi heroikisht në një rrethim më se të plotë; ndërkohë që betejat vijuan gjatë. Kronikanët shkruanin: “Qyteti i Shkodrës u mbrojt kryesisht nga shqiptarët...”, nga forca e moralit dhe gjaku i derdhur. Sipas Hasan Riza Pashës Shkodra për Turqinë ishte e humbur, deklaroi se krahas flamurit turk, duhej ngritur edhe flamuri shqiptar në kala, për të lidhur Shkodrën me qeverinë e Vlorës të Ismail Qemalit, duke i vënë serbo-malazezët para një fakti të kryer: Valiu dhe komandanti i trupave osmane mori mbështetjen e malësorëve shqiptarë, që e njihnin mirë “lojën” e Malit të Zi. Mbi këto luftime u njoftua edhe Vjena për planin e tij. Vrasja me tradhëti e Hasan Riza Pashës ishte vepër shqiptare në bashkëpunim me të huajt. Ai u vra në derën e shtëpisë së tij, sepse ishte oficeri më i kompletuar dhe më inteligjent, si dhe një komandant i madh i shtabit osman, që e deshi Shqipërinë dhe flamurin e saj. Para se të ndërronte jetë, u tha oficerëve pranë tij: “Betohuni se do ta ruani Shkodrën deri në vdekje”. Ministri i Luftës, Mehmet Dërralla për vrasjen e Hasan Riza Pashës tha: “...na e vranë në të pabesë një hero të madh”, një njeri akademik që luftoi për shqiptarët në momentet më kritike. Më 2 shkurt 1913, Krajl Nikolla, kërkoi armëpushim, edhe pse lufta e Malit të Zi dhe Serbisë mbi Berdicë dhe Bardhaj, përfundoi në një kasaphanë të vërtetë, pasi ata u goditën rëndë duke lënë në fushën e betejës mbi 2500 ushtarë. Më 10 prill 1913, kryeministri serb Pashiç urdhëroi forcat serbe të linin rrethimin e Shkodrës. Pas 6 muajsh të një mbrojtjeje heroike të Shkodrës, u tha se “mbaruan ushqimet!” për forcat osmane dhe popullsinë civile, Esat Pasha i kërkoi komandës malazeze për të vendosur kushtet e dorëzimit të kalasë. Më 23 prill 1913, ai nënshkroi marrëveshjen e dorëzimit të Shkodrës. Shkodra u tradhtua pa marrë parasysh

faktorin ushtarak të qëndresës, sepse Mali i Zi e kishte të pamundur pushtimin me armë të Shkodrës përballë shqiptarëve dhe osmanëve superiorë në qëndresën historike, që i mundën armiqtë e tyre, duke lënë mijëra të vrarë në fushëbetje, një fakt i pranuar dhe nga serbo-malazezët, Shkodranët nuk pranuan që të dorëzohej qyteti i tyre. U harrua amaneti i fundit të Hasan Riza Pashës, i këtij dëshmorë dhe heroi të qëndresës, që ishte po aq dëshmorë dhe hero se dhe cdo shqiptar që gjakun e derdhën për tokën shqiptare, sikurse ishin edhe 15 dëshmorët e Gramshit. Dorëzimi i pabesë i Shkodrës ishte “...atentat kundër pavarësisë së Shqipërisë”. Ndërsa Medi Frashëri do shprehej: “Esati është maçoku i zi i Shqipërisë”, çka dënonte ashpër aktin e tradhëtisë. Megjithëse faktori ndërkombëtar, e veçanërisht Austro-Hungaria, e kishin dhënë verdiktin e vet, që Shkodra t’i mbetej shtetit shqiptar, kishin dërguar edhe Flotën e tyre Luftarake në brigjet e Adriatikut. Më 4 maj 1913, Nikolla deklaroi: “Duhet të tërhiqemi”, e më 9 maj 1913, ai nënshkroi marrëveshjen e ridorëzimit të Shkodrës, sepse administrimi i qytetit i kaloi Komisionit Ushtarak Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK-së). Më 14 maj 1913 me largimin e trupave malazeze nga rrethimi i Shkodrës në ikje dogjën dhe plaçkitën gjysmën e pazarit të Shkodrës, morën arkivat e qytetit dhe grabitën koleksionin e armëve në kala. Pas një viti administrim ndërkombëtar, qyteti verior u bashkua me Shqipërinë e pavarur. Gjergj Fishta duke folur për mbrojtësin e Shkodrës ka thënë: “Hasan Riza Pasha do të kujtohet si atdhetari më i mirë për shpëtimin tonë nga kthetrat e malazezëve... Ai meriton të kujtohet baras me heronjtë e kombit shqiptar”. Por heronj dhe dëshmorë të kombit shqiptar janë edhe Isa Bici, Jashar Bici, Laze Xhangoli, Cane Përfundi dhe qindra të tjerë të rënë në fushën e nderit dhe për nderin e Shqipërisë.

#### **Lufta e bashkimit vëllazëror të shqiptarëve**

Sipari i Luftërave nuk u mbyll për shqiptarët as me Shkodrën dhe luftimet për mbajtjen e mbrojtjen të paktën të “Shqipërisë londineze”, sepse orekset pushtuese do të shtoheshin me taktatin e fshehtë të Londrës dhe pushtuesit Italian oreksin e kishin të tillë që Adriatikon ta shndronin në një “kanal” dhe të zgjinin ëndërrat romake. Por syri i shqiptarit në jug e veri rrinte zgjuar, sikurse ishte vigjilent deri në Luftën e Vlorës ku u bë rikonfirmimi i pavarësisë shqiptare, aq sa dëshmorë i gjuhës, shkollës dhe shqiptarizmit At Shtjefën Gjeçovi do të shprehej: “Filluan luftën të pështetun në shpresë të ndihmës së Perëndisë e të bashkimit vëllazëror, e pa të sosë a me mbetë të gjithë në lam të luftës ose me shpërthe dyert e hekurta e ledhet e çelika të armiqëve”. Ka kaluar 108 vite nga ngjarjet e fillimit të luftërave ballkanike dhe është koha për një zgjim dhe kujtesë për ata djem e burra që u përballën si trima në roje të kufijve dhe të shtetit shqiptar. Është koha për të kujtuar e nderuar në vendin e nderit që u takon për aktin e madh që kanë bërë ndaj kombit djalëria shqiptare dhe djalëria gramshiote. Edhe nëse sistemet komplekse të së kaluarës në Shqipëri nuk mundën apo nuk deshën që të kujtoheshin për këta luftëtarë, historiografia shqiptare ka detyrime kombëtare, për identifikimin një për një të të gjithë luftëtarëve dhe sidomos të rënëve në fushëbetje e historisë. Pse jo kapacitetet intelektuale aktuale e mundësojnë që të studiohen jo vetëm gojëdhënat, historikët e librat lokalë e kombëtare por të kalohet edhe në studimet e mirëfillta dokumentare jashtë hapësirës shqiptare si një arkivat shqiptare, por edhe në arkivat e Turqisë, Malit të Zi, Serbisë, Greqisë, Austrisë si dhe në përfaqësitë që kishin konsuj në Shkodër në këtë periudhë, por edhe në dokumentacionin që lidhet me KNK-në, që erdhi dhe u shtrua “këmbëkryq” në Shkodrën e pragrit të Luftës së Parë Botërore. Të tillë ishin shqiptarët dhe të tillë mbetën, duke derdhur gjak në çdo periudhë të historisë, gjak të kulluar atdhetar në rrënjët e shtetit shqiptar, sikurse ishte gjaku që derdhën në Tarabosh djemtë e Shenepremtes/Lenies, Grabovës së madhe e fshatrave të tjerë përreth Gramshit atdhetar.



BAZA DETARE E PASHALIMANIT, 12-23 TETOR 2020  
Kompania e Dytë e Policisë Ushtarake  
zhvilloi stërvitjen "Limani 20"

